



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 145

14 nëntor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 100/2012 datë 24.10.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 3 të kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin e projektit të rrugës Levan-Vlorë	8041
Ligj nr. 101/2012 datë 24.10.2012	Për ratifikimin e kontratës për blerje aksionesh të shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a., Tiranë, lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Ujësjellës-kanalizime”, sh.a. Tiranë	8043
Ligj nr. 102/2012 datë 24.10.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”	8060

LIGJ
Nr. 100/2012

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR. 3 TË KONTRATËS FINANCIARE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË INVESTIMEVE
(BEI) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËS
LEVAN – VLORË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese nr. 3 e kontratës financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin e projektit të rrugës Levan - Vlorë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.10.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7812, datë 8.11.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë
Shqipëri

Në vëmendje të: z. Ridvan Bode, Ministër
Për dijëni: Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve
Sami Frashëri, nr. 33
Tiranë
Shqipëri

Luksemburg, 16 korrik 2012
Lënda: Rruga Levan – Vlorë (FI 24.176)

JUOPS/SEE/AIA nr.



KONTRATA FINANCIARE
E LIDHUR NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË
INVESTIMEVE MË 16 NËNTOR 2007 NË TIRANË, QË ËSHTË NDRYSHUAR MË PAS
“KONTRATA E FINANCIMIT”

Ndryshimi nr. 3 i kontratës financiare

Të nderuar zotërinj,
I referohemi kontratës financiare të përcaktuar më sipër.

1. INTERPRETIMI

Përveç kur përcaktohet ndryshe, termat me germa kapitale të përdorur në këtë letër kanë të njëjtin kuptim që u caktohet në kontratën financiare. Referencat te nenet janë referenca te nenet e kontratës financiare.

Në këtë letër:

“Data e hyrjes në fuqi” do të thotë data në të cilën Banka i konfirmon Huamarrësit me shkrim (duke përfshirë postën elektronike), që: i) Banka ka marrë dy (2) origjinale të kësaj letre të sigluar rregullisht në emër të Huamarrësit, së bashku me një kopje të autoritetit përkatës të nënshkruesve, nëse nuk është dhënë më parë; ii) Banka ka marrë opinionin ligjor të parashikuar në paragrafin 3; dhe iii) nuk kërkohet asnjë dokument për të përfunduar procesin e nënshkrimit në lidhje me këtë ndryshim nr. 3.

2. NDRYSHIMET E KONTRATËS SË FINANCIMIT

Pas kërkesës suaj të datës 7 maj 2012, ne kemi kënaqësinë t’ju konfirmojmë që, me fuqi nga data e hyrjes në fuqi, kontrata financiare ndryshohet si më poshtë.

Pika 1

Pika 1 ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“Huamarrësi ka deklaruar që autoriteti shqiptar i rrugëve i themeluar pas transformimit me ligj të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në një ndërmarrje publike (Autoriteti Shqiptar i Rrugëve ose ASR) dhe derisa ASR-ja të jetë tërësisht operative si agjenci zbatuese, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, nëpërmjet ekipit të zbatimit të projektit, secili brenda Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit të Republikës së Shqipërisë (Promotori) po ndërmerr një projekt (më poshtë të quajtur “projekti”) në lidhje me ndërtimin e një rruge të shpejtësisë së lartë me 2x2 korsi ndërmjet qyteteve të Levanit dhe Vlorës me një gjatësi të përgjithshme prej 24 km, me qëllim përmirësimin e kapacitetit, sigurisë në trafik dhe kohës së udhëtimit në këtë aks madhor të rrugës veri-jug, siç është përshkruar me hollësi në përshkrimin teknik (më poshtë të quajtur “përshkrimi teknik”) i parashikuar në grafikun A.1.”.

Pika 3

Pika 3 ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“Me qëllim që të përmbushet plani i financimit i parashikuar në pikën 2, Huamarrësi i ka kërkuar Bankës një kredi deri në 26,000,000 euro (njëzet e gjashtë milionë euro) për financimin e projektit.”.

Neni 1.01

Në nenin 1.01, shuma prej 23,000,000 euro (njëzet e tre milionë euro) ndryshohet duke u bërë “26, 000, 000 euro (njëzet e gjashtë milionë euro)”.

Neni 1.02 (2)

Në nenin 1.02 (2), datë 30 qershor 2012 ndryshohet me tekstin “31 mars 2013”.

Ndryshimet në grafik A (A.1.) - Përshkrimi teknik

a) Fjalja e dytë e paragrafit me titull “Qëllimi, vendndodhja” (d.m.th. “Projekti përfshin gjithashtu përgatitjen e studimeve të fizibilitetit, vlerësimeve të ndikimit në mjedis dhe auditimet e sigurisë rrugore për projektet në të ardhmen të përfshira në programin e investimeve në rrugë dhe që konsiderohen për financim nga EIB”), fshihet tërësisht.

b) Paragrafi me titull “Kalendari” ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“Pritet që punët e ndërtimit të përhershëm të fillojnë në tetor të vitit 2007 dhe projekti të përfundojë deri më 31 gusht 2012”.

3. KUSHTI PËR HYRJEN NË FUQI TË NDRYSHIMIT NR. 3

Hyrja në fuqi e këtij ndryshimi nr. 3 kushtëzohet nga marrja nga Banka të një opinionit ligjor nga Ministri i Drejtësisë të Huamarrësit që shprehet mbi: i) autorizimin e shumës së rishikuar të kredisë; ii) natyrën ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të ekzekutueshme të detyrimeve ligjore të Huamarrësit; iii) mungesën e kontroleve të këmbimit të huaj; dhe iv) përfshirjen e kontratës financiare të ndryshuar në objektin e marrëveshjes kuadër.

4. DETYRIMET QË MBETEN

Huamarrësi pranon dhe bie dakord që, përveç kur parashikohet dhe bihet dakord këtu, kjo letër nuk përbën heqje dore të dhënë nga Banka ose ndryshim të një afati apo kushti të kontratës financiare. Banka rezervon të gjitha të drejtat kontraktuale dhe ligjore që ajo ka sipas kontratës financiare dhe ligjit të zbatueshëm.

5. LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

Kjo letër rregullohet nga ligjet e Dukatit të Madh të Luksemburgut dhe palët i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian.

Palët e kësaj kontrate heqin dorë nga çdo imunitet ose e drejtë për të kundërshtuar juridiksionin e Gjykatës. Çdo vendim i Gjykatës i dhënë në pajtim me nenin 11.03 është përfundimtar dhe detyrues për palët pa kufizim ose rezervë.

Nëse bini dakord me sa më sipër, jeni të lutur t'i ktheni bankës dy (2) kopjet origjinale të kësaj letre, në vëmendje të z. Lawrence Walsh (tel: +352 4379 83477, e-mail: walshl@eib.org), të sigluar në çdo faqe, me datë dhe në emër të Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e saj si huamarrëse, së bashku me një kopje të autoritetit përkatës të nënshkruesve, nëse kjo nuk është bërë dhe opinionin ligjor sipas paragrafit 3, deri dhe jo më vonë se 31 gusht 2012.

Jeni të lutur të dërgoni për informacion një kopje të këtij dokumenti të ndryshimit nr. 3, pas nënshkrimit të rregullt, te Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve.

Me respekt,
Banka Europiane e Investimeve
Dominique Courbin Massimo Novo

Marrë dijeni dhe rënë dakord për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë
Përfaqësuar nga Ministria e Financave

Z. Ridvan Bode, Ministër

LIGJ Nr. 101/2012

PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS PËR BLERJE AKSIONESH TË SHOQËRISË “HEC LANABREGAS” SHA TIRANË, LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS DHE SHOQËRISË “UJËSJELLËS - KANALIZIME” SHA TIRANË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet kontrata për blerje aksionesh të shoqërisë “Hec Lanabregas” sh.a. Tiranë, lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Ujësjiellës-kanalizime” sh.a. Tiranë.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 24.10.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7813, datë 8.11.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**KONTRATË PËR BLERJE AKSIONESH
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË
“UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE” SHA TIRANË
Tiranë, më 8.5.2012**

Sot, në datën 9.5.2012 në Tiranë, përpara meje noterit Shpresa Kurti, notere e Dhomës së Noterëve, Tiranë, u paraqitën përfaqësuesit e palëve të mëposhtme:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, e përfaqësuar nga Ministri z. Nasip Naço (më poshtë referuar si “shitësi ose METE”); dhe

Shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a. Tiranë, një shoqëri e krijuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë (më poshtë referuar, si “blerësi” ose “shoqëria”, me seli në Tiranë, e përfaqësuar nga z. Sahit Dollapi, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë.

Unë, noteri, pasi verifikova dokumentacionin e paraqitur nga palët ose përfaqësuesit e tyre, vërtetova se përfaqësuesit janë legjitimë, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar dhe me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, kanë kërkuar dhe kanë rënë dakord për hartimin e kësaj kontrate, sipas afateve dhe kushteve të mëposhtme:

Meqenëse ekzistojnë këto kushte paraprake:

Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 705 e vijues;

Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar;

Ligji nr. 7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, neni 4;

Në bazë të ligjit nr. 10 430, datë 9.6.2011 “Për krijimin e shoqërive “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a., “HEC Tiranë, Lanabregas” sh.a. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. dhe përcaktimin e formës e të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. është krijuar shoqëria “HEC Tiranë, Lanabregas” sh.a.

Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 717, datë 20.10.2011 “Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “HEC Lanabregas” sh.a. Tiranë, të zotëruara nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, shoqërisë “Ujësjellës-kanalizimeve” sh.a., Tiranë është miraturar transferimi i 100% të aksioneve nga METE te shoqëria “Ujësjellës-kanalizimeve” sh.a. Tiranë, nëpërmjet kontratës së blerjes.

METE dhe shoqëria “Ujësjellës-kanalizimeve” sh.a. Tiranë janë palët për negocimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate.

Është evidentuar lista e aseteve të kësaj shoqërie nga ndarja me shoqërinë KESH sh.a.;

Nga ekspertët vlerësues është përcaktuar vlera minimale prej 14 milionë eurosh;

Është bërë remonti total i “HEC-it Lanabregas”;

Duke marrë dhe në konsideratë gjendjen teknike dhe perspektivën e mundësinë për fuqizimin e rritjen e fuqisë instaluese e të prodhimit; si dhe

Të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të këtij burimi ujor e të rezervuarit të “HEC Lanabregas” dhënë kësaj shoqërie.

Duke marrë parasysh sa më sipër, palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1 **Përkufizime**

Përveç, termave të tjerë të përkufizuar ndryshe në këtë kontratë, për qëllimet e saj, fjalët dhe termat që vijojnë do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

“Llogaritë” do të thotë pasqyrat financiare të kontrolluara të shoqërisë, të përgatitura në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit të pranuar në Shqipëri, për vitin ushtrimor të mbyllur në datën e fundit kontabël, siç rezulton në regjistrin e Zyrës së Tatimeve, Tiranë dhe siç parashikohet në shtojcën A.

“Kontratë” do të thotë kjo kontratë për blerje aksionesh, duke përfshirë si pjesë përbërëse të saj, kushtet paraprake të mësipërme, si dhe shtojcat bashkëngjitur, nënshkruar dhe përfunduar.

“Shoqëria” do të thotë shoqëria “HEC Lanabregas” sh.a. Tiranë.

“Licenca” do të thotë licencat që janë lëshuar nga ERE dhe entet e tjera të caktuara me ligj.

“Mbyllja” do të thotë finalizimi i shitjes dhe blerjes së aksioneve sipas kësaj kontrate, si rrjedhojë e përmbushjes nga palët e detyrimeve të tyre respektive.

“Data e mbylljes” do të jetë data e përcaktuar në nenin 4.

“Dëm” i referohet çdo dëmi financiar të shkaktuar nga palët si pasojë e drejtpërdrejtë e shkeljes së një deklarimi dhe/apo garancie, përfshirë këtu shpenzimet e arsyeshme të kryera në përpjekje për të parandaluar apo pakësuar dëmin.

“Legjislacion” do të thotë çdo akt normativ kombëtar apo lokal, urdhër, dekret apo ligj tjetër (përfshirë legjislacionin për mjedisin) rregullore ose statut apo çdo rregull, kod, direktivë apo çdo licencë, aprovim, leje apo autorizim apo miratime të tjera në fuqi, të Republikës së Shqipërisë apo të çdo njësie apo ndarjeje administrative ose të çdo personi të krijuar me ligj (qoftë apo jo autonom), që ka juridiksionin përkatës, për sa kohë që është publikuar apo publikisht i aksesueshëm, dhe subjekt i vendimeve të gjykatave dhe trupave gjykues të ndryshëm të Republikës së Shqipërisë, vendimeve dhe akteve të ministrave, qarkulloreve të departamenteve, si dhe deklaratat dhe interpretimet e organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë që kanë juridiksion mbi çështjen në fjalë; përfshirë ndryshimet e herëpashershme të tyre.

“Periudhë para mbylljes” do të thotë periudha nga data e nënshkrimit, përfshirë këtë datë, deri në datën e mbylljes, përfshirë këtë datë.

“Data e nënshkrimit” do të thotë dita në të cilën është nënshkruar kjo marrëveshje nga të dy, blerësi dhe shitësi, siç paraqitet në faqet e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

“Taksat” apo “tatimi” do të thotë të gjitha llojet e barrës fiskale dhe të taksave në Shqipëri, tarifave doganore dhe detyrimeve të tjera të natyrës fiskale, përfshirë interesat, gjobat apo detyrimet e tjera të lidhura, të pagueshme ndaj apo të ngarkuara nga një autoritet tatimor, doganor etj., si dhe të gjitha kontributet për sigurimet shoqërore dhe kontributet e detyrueshme për sigurimet shëndetësore.

“ERE” do të thotë Enti Rregullator i Energjisë Elektrike.

OBJEKTI DHE QËLLIMI I TRANSAKSIONIT

Neni 2 **Blerja e aksioneve në shitje**

Sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate, në datën e mbylljes shitësi do t’i shesë blerësit duke i dhënë garanci të plotë për titullin dhe blerësi do të blejë nga shitësi, aksionet në shitje dhe çdo të drejtë që lidhet me to, të lira nga çdo barrë, me një vlerë të barabartë me shumën e përcaktuar në nenin 3 dhe të pagueshme, sipas mënyrës që përcaktohet po aty.



Mbyllja e transaksionit që parashikohet në këtë kontratë e që do të kryhet në datën e mbylljes do të zhvillohet pranë zyrave të shitësit.

Neni 3

Çmimi i blerjes dhe mënyra e pagesës

Çmimi total i blerjes së aksioneve në shitje është 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milionë) euro (në vijim “çmimi i blerjes”) dhe do të paguhet menjëherë, në përputhje sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Të drejtat e blerësit mbi dividendin për çdo aksion në shitje do të maturohen, duke filluar nga data e mbylljes.

Neni 4

Nënshkrimi dhe mbyllja

4.1 Menjëherë pas nënshkrimit, çdo palë do të fillojë punët përgatitore për të organizuar rregullisht mbylljen dhe për të përmbushur të gjitha kushtet parapake që parashikohen në këtë kontratë. Palët bien dakord që kjo kontratë është një marrëveshje me kusht dhe kushti është ndodhja e mbylljes.

4.2 Mbyllja do të realizohet në datën e mbylljes pranë zyrave të shitësit në Tiranë, apo në një vend, datë, orë tjetër, siç do të përcaktohet me marrëveshje të përbashkët nga palët.

4.3 Në datën e mbylljes:

a) Shitësi:

1. Do të dorëzojë certifikatat që përfaqësojnë aksionet në shitje, të cilat duhet të jenë lëshuar dhe përgatitur para datës së mbylljes, të nënshkruara rregullisht në favor të blerësit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar;

2. Do të nënshkruajë dhe do të dorëzojë dhe/ose të bëjë të mundur nënshkrimin dhe dorëzimin e dokumenteve të tjera të nevojshme sipas legjislacionit shqiptar, në mënyrë që t'i kalojë blerësit një titull të mirë dhe të tregtueshëm mbi aksionet në shitje dhe për të përmbushur siç duhet qëllimin e kësaj kontrate, përfshirë noterizimin e saj;

3. Do të bëjë të mundur dorëheqjen e të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, të administratorit të shoqërisë, si dhe të ekspertëve kontabël të shoqërisë nëpërmjet paraqitjes së letrave të dorëheqjes së tyre pranë shoqërisë, dhe të caktojë në pozicionet e tyre, personat e propozuar nga palët dhe të zgjedhur në përputhje me paragrafin e parafundit të nenit 4.3, të cilët do të jenë në këto detyra që nga data e mbylljes, nëpërmjet thirrjes së asamblesë së përgjithshme të shoqërisë në datën e mbylljes dhe dorëzimit të blerësit të vendimeve të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë;

4. Do të ketë marrë aprovimin e ERE-s për transferimin e aseteve për llogari të “Ujësjellës-kanalizime” Tiranë; dhe

b) Blerësi do t'i dorëzojë shitësit dokumentet e mëposhtme:

1. Deklaratën e çmimit të blerjes, në shumat e përcaktuara në nenin 3;

2. Një ekstrakt nga regjistri tregtar për blerësin, të lëshuar brenda 10 (dhjetë) ditëve pune para mbylljes;

3. Një certifikatë të noterizuar që vërteton gjendjen e mirë financiare të blerësit;

4. Një kopje të noterizuar të vendimit të organeve kompetente të blerësit, që miraton blerjen e aksioneve në shitje;

5. Blerësi të sigurojë që të jenë marrë të gjitha vendimet e organeve kompetente të saj të nevojshme për të ndërmarrë detyrimet e parashikuara në këtë kontratë me qëllim ekzekutimin dhe zbatimin e transaksionit.

Në datën e mbylljes, blerësi do të fitojë titullin mbi aksionet në shitje dhe shitësi po në këtë datë do të regjistrojë blerësin në regjistrin e aksioneve të shoqërisë. Blerësi do të përfitojë çdo dividend të deklaruar ose të paguar, si dhe do të gëzojë të gjitha të drejtat e tjera që lidhen me to, duke filluar nga data e mbylljes.

Në datën e mbylljes, shitësi do të mundësojë thirrjen e mbledhjes së aksionarëve të shoqërisë, me rend dite që do të përcaktohet me marrëveshjen me blerësin përpara datës së mbylljes dhe do të përfshijë, ndër të tjera, emërimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar në vend të atyre që kanë dhënë dorëheqjen.

Kur të kryhet mbyllja, të gjitha veprimet e mbylljes do të konsiderohen se kanë ndodhur në të njëjtën kohë në datën e mbylljes dhe asnjë transferim ose dorëzim nuk do të quhet i përfunduar derisa të gjitha veprimet e mbylljes të kenë përfunduar, siç parashikohet në këtë nen 4.3.

Neni 5

Deklarimet dhe garancitë e shitësit

Shitësi, me anë të kësaj kontrate, deklaron dhe garanton në lidhje me shoqërinë, si dhe me transaksionin që parashikohet në këtë kontratë, për të gjitha çështjet që vijnë deri në datën e nënshkrimit të saj. Shitësi, gjithashtu, deklaron dhe garanton se ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin përkatës për shoqërinë për qëllimet e transaksionit.

Shitësi, gjithashtu, garanton se çdo garanci dhe deklarim do të jetë i vërtetë, i saktë dhe jo i keqpërdorur në datën e mbylljes.

5.1 Organizimi

Shoqëria “HEC Lanabregas” sh.a. Tiranë, është një shoqëri e krijuar dhe e themeluar rregullisht sipas ligjeve shqiptare, nuk është në gjendje paaftësie paguese apo në falimentim dhe ka fuqi të plotë dhe kompetenca për të kryer aktivitetin e saj, siç i kryen aktualisht, si dhe të zotërojë asete dhe prona siç i zotëron aktualisht.

Shoqëria operon me licenca të vlefshme, me ndryshimet përkatëse siç përcaktohet në shtojcën B e C, nuk kanë shkelur asnjë prej afateve të këtyre licencave dhe nuk kërkohet asnjë licencë tjetër që kjo shoqëri të kryejë aktivitetin e saj, siç e zhvillon aktualisht.

5.2 Autorizimi

Pavarësisht nga sa parashikohet në nenin 10.1 të kontratës, të gjitha aktet ligjore dhe/ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të shitësit dhe që autorizojnë shitësin të lidhë dhe të zbatojë këtë kontratë janë kryer rregullisht; kjo kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga shitësi dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për shitësin dhe që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj kontrate.

5.3 Mungesa e konflikteve

Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj kontrate, si dhe përfundimi i transaksionit që parashikohet në këtë kontratë dhe përmbushja e kushteve, afateve dhe dispozitave të kësaj kontrate nga shitësi nuk janë dhe nuk do të jenë në konflikt ose nuk do të rezultojnë në ndonjë shkelje apo mospërmbushje ose nuk do të mundësojnë krijimin e ndonjë të drejte për përfundimin, anulimin, ose përshpejtimin e ndonjë detyrimi, ose humbjeje të ndonjë përfitimi material, ose nuk do të krijojnë ndonjë barrë mbi çdo aktivitet, aset ose pronë të shitësit, sipas dispozitave të një vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të detyrueshme për shitësin.

5.4 Pronësia

Shitësi është pronari dhe përfituesi i vetëm dhe i ligjshëm i aksioneve në shitje, në një total prej 100% (një qind për qind) të aksioneve, që përbën numrin e aksioneve në shitje dhe deklaron, dhe garanton si aksionari i vetëm i shoqërisë se shoqëria është pronari dhe përfituesi i vetëm dhe i ligjshëm i të gjitha aksioneve që përbëjnë kapitalin.

Aksionet në shitje janë të përcaktuara dhe të emetuara rregullisht, si dhe janë paguar plotësisht. Aksionet në shitje janë të lira dhe të çliruara nga çdo barrë e çfarëdolloji dhe shitësi ka të gjitha të drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plotë për t'i shitur, për t'i kaluar, për t'i transferuar dhe për t'i dorëzuar aksionet në shitje në përputhje me afatet e kësaj kontrate.

Nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje ose detyrim që krijon ose vendos ndonjë barrë në lidhje me aksionet në shitje, ose ndonjë numër aksionesh të autorizuar, por të paemtuara në kapitalin e shoqërisë. Asnjë person nuk pretendon se ka ndonjë të drejtë mbi ndonjë barrë lidhur me ndonjë nga aksionet në shitje.



Përveç kësaj kontrate, nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje ose detyrim që parashikon krijimin, dhënien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin, ose dhënien e së drejtës një personi (të kushtëzuar ose jo) për të kërkuar dhënien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e ndonjë aksioni të kapitalit të shoqërisë (që përfshin, por pa u kufizuar në një preferencë, të drejtën për të ofruar i pari ose të drejtën e parablerjes ose këmbim).

5.5 Llogaritë

Llogaritë e shoqërisë të datës së fundit kontabël që i janë vënë në dispozicion blerësit dhe që bashkëngjiten këtu si shtojca A janë përgatitur në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit të pranuar në Shqipëri.

5.6 Regjistrat kontabël dhe libra të tjerë të shoqërisë

Regjistrat kontabël dhe librat e shoqërisë janë të azhuruara, në zotërim ose nën kontrollin e shoqërisë dhe mbahen në mënyrën e duhur dhe të gjitha regjistrimet në këto regjistra dhe libra kontabël janë mbajtur rregullisht dhe në përputhje me ligjet shqiptare dhe me standardet, parimet dhe praktikat e zbatueshme të vendit.

5.7 Mungesa e ndryshimeve materiale

Aktiviteti i shoqërisë është zhvilluar normalisht në mënyrë që të mbahet si një aktivitet i vazhdueshëm; dhe nuk ka ndodhur asnjë ndryshim material (thelbësor), në përmbajtjen, strukturën dhe vlerën e aseteve, si dhe të detyrimeve siç tregohet në llogaritë, si dhe nuk ka ndodhur asnjë zbritje materiale e vlerës së aktiveve neto të trupëzuara të shoqërisë (përveç rastit të amortizimit të zakonshëm dhe të zhvlerësimit), në bazë të vlerësimit të përdorur në llogaritë. Që nga data e fundit kontabël, shoqëria është administruar dhe ka funksionuar në mënyrën e duhur dhe shoqëria:

nuk ka lidhur asnjë marrëveshje, me përjashtim të atyre që tregohen në shtojcën D; ose nuk i është ngarkuar asnjë detyrim material, nuk ka pësuar asnjë përgjegjësi materiale ose ndryshim material përkeqësues; ose nuk ka ndërmarrë asnjë veprim tjetër, i cili mund të shkaktojë që çdonjëri prej deklarimeve dhe garancive të shitësit që parashikohet në këtë kontratë, të bëhet e pavërtetë ose e parregullt.

Shoqëria "HEC Lanabregas" sh.a. Tiranë që nga data e fundit kontabël:

a) nuk ka pësuar ndonjë ndryshim material përkeqësues lidhur me asetet, pronat ose aktivitetet e saj të biznesit;

b) nuk ka pësuar asnjë ngjarje ose rrethanë materiale në lidhje me asetet, biznesin ose pronat që rrezikon materialisht, të ndërpresë, të pengojë, të dëmtojë ose përndryshe të cenojë materialisht dhe në mënyrë përkeqësuese rezultatin e veprimtarisë së saj në tërësi;

c) nuk ka nënshkruar asnjë transaksion ose kontratë, ose hapur ndonjë procedurë prokurimi, përveç atyre të përcaktuara në shtojcën E; ose nuk ka ndryshuar ose përfunduar ndonjë transaksion ose kontratë, vlera e të cilëve kalon shumë prej 100 000 (njëqind mijë) eurosh dhe që mund të shkaktojë një ndryshim material përkeqësues në asetet, pronat dhe aktivitetet e biznesit të shoqërisë;

d) nuk ka shitur, transferuar, vënë peng, dhënë me qira ose përndryshe disponuar ndonjë aset ose pronë që zotëron shoqëria;

e) nuk ka punësuar personel ose nuk kanë rritur shkallën e kompensimit të pagueshëm ose për t'u paguar ndaj punonjësve, përveç rritjes sipas praktikave të mëparshme dhe në përputhje me çdo shpërblim aktual ose me plane të tjera, ose nuk kanë ndryshuar organizimin e punës në ndonjë mënyrë materiale;

f) nuk ka fituar ose marrë me qira ndonjë pasuri të paluajtshme ose nuk ka bërë ndonjë shpenzim kapitali (të trupëzuar ose të patrupëzuar), përveç kontratës së qirasë së zyrave me vlerë 3500 (tri mijë e pesëqind) euro në muaj;

g) nuk ka fituar ose disponuar, në çfarëdolloj forme, interesa në kapitalin e shoqërive të tjera ose nuk ka fituar, disponuar ose hyrë në marrëdhënie qiraje (si qiramarrës ose qiradhënës) për ndonjë aktivitet apo për ndonjë pjesë të aktivitetit;

h) nuk ka deklaruar ose paguar asnjë dividend me përjashtim të shumës së përcaktuar në bilancin e shoqërisë për vitin 2011, që përbën dividendin e shpërndarë të shoqërisë, për vitin 2011, ose nuk ka blerë ose përndryshe nuk ka fituar ndonjë interes në kapitalet e saj;

i) nuk ka hyrë në, rritur ose shtuar, ndonjë detyrim në lidhje me ndonjë garanci ose dëmshpërblim, ose tjetër jashtë zhvillimit normal të aktivitetit të saj;

j) nuk ka vonuar pagesa, ndryshuar fatura dhe ristrukturuar pagesa, ose kushtet e pagesave apo të tjera, ndryshe nga praktikat e mëparshme të zbatueshme të biznesit;

k) nuk ka paguar, likuiduar apo përmbushur ndonjë pretendim, përgjegjësi ose detyrim jashtë ushtrimit normal të biznesit të saj;

l) nuk ka rënë dakord për të kryer sa përmendet më lart.

5.8 Taksa dhe konfliktet

Shoqëria ka depozituar në kohën e duhur të gjitha deklaratat periodike dhe vjetore fiskale që parashikohen nga legjislacioni fiskal i zbatueshëm në lidhje me to. Këto deklarata tatimore janë përgatitur rregullisht dhe të gjitha detyrimet tatimore direkte ose indirekte të pagueshme, janë paguar plotësisht dhe në kohë. Për sa më sipër, autoritetet tatimore shqiptare do të lëshojnë raporte të plota kontrolli tatimor për shoqërinë, për periudhën që përfshin vitet 2011 deri në datën e fundit kontabël, siç përcaktohet në shtojcën F.

Nuk ka asnjë konflikt gjyqësor në proces ose konflikt të mundshëm për t'u kthyer në proces gjyqësor në lidhje me shoqërinë, siç përcaktohet në shtojcën G.

Shoqëria nuk është në proces hetimi dhe procedimi nga ERE ose Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës, si pasojë e të cilave mund të vendoset një gjobë mbi ndonjë çështje rregullatore, duke përfshirë, por pa u kufizuar, tarifatat e sigurimit, tarifatat, marrëdhëniet midis degëve, detyrimet e interkonjeksionit.

5.9 Aktivitetet e trupëzuara

Shoqëria ka titull pronësie të plotë, të mirë, të regjistruar dhe të tregtueshëm mbi të gjitha asetet dhe pronat e saj, që pasqyrohen në llogaritë e datës së fundit kontabël apo që janë fituar pas kësaj date, siç tregohet në shtojcat I dhe H, dhe ky titull nuk është objekt i ndonjë kufizimi, hipoteke, pengu, barre, detyrimi ose të drejte të çfarëdolloji në përfitim të palëve të treta.

Rrjeti i HEC-it, siç përcaktohet në listën e inventarëve, që i bashkëngjitet kontratës, si shtojca I dhe H, është në pronësi të shoqërisë dhe, si rrjedhojë menaxhimi i këtij rrjeti do të kryhet nga shoqëria. Shoqëria do të vazhdojë të gëzojë të gjitha të drejtat reale që ka gëzuar për funksionimin normal të aktivitetit të saj.

5.10 Aktivitetet e patrupëzuara

Shoqëria është pronarja e vetme dhe ekskluzive ose ka të drejtë të përdorë markat tregtare, patentat, emrat tregtarë, njohuri teknike (*know-how*) të saj, si dhe çdo të drejtë tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale të saj të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të saj (Aktivitetet e patrupëzuara), siç tregohen në shtojcën H dhe nuk është në shkëlqje të asnjë prej aktiveve të patrupëzuara të saj. Këto aktive të patrupëzuara janë plotësisht të përdorshme nga ana e shoqërisë pa qenë nevoja për pagimin e ndonjë licence, tarife, rente (*royalty*), ose ndonjë detyrimi tjetër të ngjashëm.

5.11 Punonjësit

Të gjithë punonjësit e shoqërisë janë të regjistruar rregullisht në librat dhe regjistrat përkatës, bashkë me shpërblimet në total që i paguhen secilit prej tyre, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme. Në ditën e nënshkrimit, shoqëria ka një numër total prej 63 (gjashtëdhjetë e tre) punonjës sipas listës bashkëlidhur.

Shoqëria ka bërë të gjitha depozitimet dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet që duhen kryer apo të ndërmerren, sipas ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme për sigurimet shoqërore, për marrëdhëniet e punës dhe mirëqenien për secilin nga punonjësit, përfshirë këtu, për shmangien e çdo dyshimi. Të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe mirëqenien në bazë të ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme, si dhe të kontratës kolektive, nëse ka, janë paguar plotësisht siç tregohet në shtojcën K.

Çdo anëtar i këshillit mbikëqyrës, anëtar i drejtorisë ose çdo ekspert kontabël i shoqërisë dhe çdo punonjës, ka marrë në vitin e fundit financiar vetëm shumat e paraqitura në llogaritë dhe asnjë prej tyre nuk ka të drejtë të marrë ndonjë shumë tjetër, përveç atyre që tregohen në këto llogari.



Të gjithë punonjësit do të vazhdojnë marrëdhëniet e punës me shoqërinë sipas afateve të përcaktuara në kontratat kolektive dhe individuale të punës. Çdo ristrukturim, pas përfundimit të këtyre afateve, do të kryhet duke zbatuar të gjitha të drejtat e punonjësve të parashikuara në Kodin e Punës.

5.12 Pajtueshmëria me ligjin

Shoqëria nuk ka shkelur asnjë statut, ligj, rregull, rregullore, urdhër, dekret, udhëzim, leje ose dispozita të ngjashme të zbatueshme mbi asetet dhe pronat (qofshin këto të luajtshme ose të paluajtshme, të trupëzuara apo të patrupëzuara, në pronësi, të licencuara, të marra me qira ose ndryshe) ose mbi kontratat dhe të drejtat që ka shoqëria, të cilat mund të shkaktojnë një ndryshim material përkeqësues mbi aktivitetin dhe biznesin e saj.

Shoqëria zotëron në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme dhe nuk ka shkelur asnjë leje, licencë, apo miratime ose autorizime të tjera, që parashikohen prej ligjeve, rregullave, rregulloreve, urdhrave, dekretëve ose udhëzimeve të zbatueshme për pronësinë, përdorimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e aktivitetit të saj ose për çdo aset dhe pronë të saj ose për çdo kontratë dhe të drejtë, që shoqëria ka detyrimin të zbatojë.

Shoqëria, rrjeti i saj, pajisjet dhe në përgjithësi mënyra se si shoqëria ushtron aktivitetin e saj është në përputhje me legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit. Shoqëria nuk ka detyrime në lidhje me mjedisin.

Procesi i privatizimit të shoqërisë dhe përzgjedhja e blerësit është kryer në përputhje me ligjin për privatizimin, me ndryshimet përkatëse dhe me çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm.

5.13 Çështjet gjyqësore

Në shtojcën G është pasqyruar raporti i saktë në lidhje me çështjet gjyqësore në proces të “HEC Lanabregas”. Shitësi nuk është në dijeni të ndonjë pretendimi tjetër të palëve të treta që është në proces gjyqësor dhe/ose arbitrazhi apo që rrezikon të ngrihet ndaj “HEC Lanabregas”.

5.13 Garancitë, detyrimet dhe dëmshpërblimet

Shoqëria nuk ka asnjë detyrim të papaguar dhe nuk ka rënë dakord të krijojë ose të marrë hua, të marrë borxh ose detyrime të natyrës së huamarrjes, me përjashtim të atyre që tregohen në shtojcën L.

Shoqëria nuk është palë dhe nuk është përgjegjëse në bazë të ndonjë marrëveshjeje sigurorese, dëmshpërblimi ose marrëveshjeje tjetër për të siguruar ose për të marrë përsipër ndonjë detyrim financiar ose detyrim tjetër në lidhje me detyrimet e një pale të tretë.

5.14 Mbyllja, administrimi dhe pamundësia e pagesës

Nuk është miratuar asnjë urdhër, nuk është paraqitur asnjë petition dhe nuk është marrë asnjë vendim për mbylljen e shoqërisë ose për emërimin e një likuidatori të përkohshëm për shoqërinë dhe nuk është miratuar asnjë urdhër për vënien në administrim të shoqërisë; dhe se shoqëria nuk është në pamundësi ose e paaftë të paguajë borxhet e saj.

5.15 Pullat e taksës, taksat dhe detyrime të tjera

Nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pullat, taksat, përfshirë TVSH-në (tatimi mbi vlerën e shtuar) ose detyrime të tjera të pagueshme nga blerësi në lidhje me këtë kontratë dhe me transferimin e aksioneve në emër të blerësit.

Neni 6

Deklarimet dhe garancitë e blerësit

Blerësi bën deklarime dhe i jep garancitë e mëposhtme shitësit dhe secila prej tyre do të jetë e vërtetë dhe e saktë në datën e mbylljes.

6.1 Organizimi

Blerësi është një shoqëri e themeluar dhe e organizuar rregullisht dhe që ushtron veprimtarinë e tij, sipas së drejtës së Republikës së Shqipërisë, nuk është në gjendje paaftësie paguese dhe ka kompetenca dhe autoritet të plotë të kryejë aktivitetin e tij, siç e kryen aktualisht dhe të zotërojë asetet dhe pronat e tij, siç i zotëron aktualisht.

6.2 Autorizimi

Të gjitha aktet e shoqërisë dhe/ose procedurat e tjera që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të blerësit që autorizojnë blerësin të lidhë dhe të zbatojë këtë kontratë janë ndërmarrë rregullisht, kjo kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar nga blerësi në mënyrën e duhur dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv ndaj tij, në përputhje me afatet dhe kushtet e saj.

Për nënshkrimin e kësaj kontrate nuk duhet asnjë njoftim tjetër ose depozitim, miratim, autorizim i çfarëdolloj nga ndonjë autoritet publik kombëtar apo nga ndonjë autoritet qeveritar ose rregullator apo nga ndonjë autoritet tjetër në shtetin e blerësit.

6.3 Mungesa e komisionerëve/brokerave

Blerësi nuk ka detyrime për të paguar ndonjë komision, tarifë ndërmjetësimi ose pagesa të ngjashme në lidhje me transaksionin e parashikuar në këtë kontratë, pagimi i të cilave mund të pretendohet në mënyrë të vlefshme nga shoqëria ose shitësi.

6.4 Mungesa e konflikteve

Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj kontrate, përfundimi i transaksioneve të parashikuara nga kjo kontratë dhe përmbushja e kushteve, afateve dhe dispozitave të kësaj kontrate nga blerësi nuk do të bjerë në konflikt, nuk do të shkelë apo mos përmbushë ose të krijojë ndonjë të drejtë për përfundimin, anulimin ose përshpejtimin e ndonjë detyrimi ose humbjeje në përfitim material, dhe as nuk do të krijojë barrë mbi ndonjë aktivitet, aset ose pronat e blerësit, sipas dispozitave të: i) statutit të blerësit ose të dokumenteve të tjera të shoqërisë; ose ii) të ndonjë kambiali, bonoje, hipoteke, porosi, akt besimi, licencë, qira, kontratë ose marrëveshje, në të cilët blerësi është palë; ose iii) të ndonjë vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të zbatueshme për blerësin ose mbi biznesin, asetet ose pronat e blerësit.

Nënshkrimi i kësaj kontrate nuk përbën shkelje të ndonjë ligji ose apo të vetë akteve të shoqërisë të blerësit, që mund të ndikojnë në vlefshmërinë ose ekzekutimin e kësaj kontrate.

6.5 Due diligence

Blerësi deklaron se ka kryer kontrollin e tij *due diligence* mbi biznesin dhe veprimtarinë e shoqërisë dhe se nuk është mbështetur dhe as mbështetet në asnjë deklaram apo garanci nga ana e shitësit, përveç atyre që parashikohen në këtë kontratë.

Neni 7

Premtimet dhe detyrimet e shitësit

7.1 Shitësi premtan se gjatë periudhës midis nënshkrimit dhe mbylljes:

i) Shoqëria do të ushtrojë aktivitetet e saj brenda kufijve të administrimit të zakonshëm, përveçse kur është rënë dakord ndryshe me shkrim me blerësin;

ii) Shoqëria do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për të ruajtur asetet dhe pronat e saj në vlerën që parashikohet në llogaritë, si edhe organizimin e biznesit, klientët dhe personelin;

iii) Shoqëria nuk do të lëshojë ose emtojë (qoftë me të drejtën preferenciale ose ndonjë të drejtë tjetër të konvertueshme në aksione apo tjetër mbi aksionet) asnjë aksion në kapitalin e shoqërisë;

iv) Shoqëria nuk do të kryejë asnjë ndryshim në aktet e saj të themelimit dhe rregulloret e brendshme, përveçse kur parashikohet ligjërisht për shitjen e aksioneve;

v) Shoqëria nuk do të ndryshojë afatet dhe kushtet e punësimit për asnjë nga drejtorët ose stafin profesional të vjetër të saj ose nuk do të kryejë pagesa përfshirë shpërblime për punonjësit e tyre, ndryshe nga sa parashikohet në kontratat ekzistuese, në kontratat kolektive ose në praktikat e zakonshme të mëparshme ose të punësojnë punonjës të rinj ndryshe nga zhvillimi i zakonshëm i aktivitetit të shoqërisë.

vi) Shoqëria nuk do të përfitojë ose nuk do të disponojë ose të bjerë dakord për të përfituar ose për të disponuar ndonjë aset material apo pronë;

vii) Shoqëria nuk do të ndërpresë apo të ndalojë zhvillimin e gjithë apo një pjese materiale të biznesit të tyre;



viii) Shoqëria do të përmbushë të gjitha detyrimet ndaj autoriteteve rregullatore, tatimore dhe atyre të sigurimeve shoqërore;

ix) Shoqëria nuk do të nënshkruajë ose të rrisë ose të zgjerojë ndonjë përgjegjësi nën ndonjë garanci ose dëmshpërblim, ose tjetër jashtë kufijve të aktivitetit të zakonshëm të biznesit të tyre;

x) Shoqëria nuk do të hyjë në asnjë marrëveshje që nuk përfundohet mbi baza të barabarta dhe të drejta për palët e saj, ose që mund të shkaktojë një ndryshim material përkeqësues;

xi) Shoqëria nuk do të lidhë asnjë kontratë që nuk është brenda kufijve të zhvillimit të zakonshëm të bizneseve të tyre dhe do të marrë miratimin me shkrim të blerësit për kontrata, vlera e të cilave kalon shumë prej 400,000 (katërqind mijë) lekësh;

xii) Shoqëria do të përpiqet që standardet e shërbimeve që u ofrojnë klientëve të jenë së paku shërbim me standard dhe cilësi të krahasueshme me shërbimet që këto shoqëri u kanë ofruar klientëve para datës së nënshkrimit të kësaj kontrate;

xiii) Shoqëria nuk do të vonojë pagesat, nuk do të ndryshojë faturimet ose nuk do të ristrukturojë kushtet e pagesave për borxhet e tyre ndryshe nga praktikat e mëparshme të biznesit të tyre, që mund të shkaktojë një ndryshim material përkeqësues;

xiv) Shoqëria nuk do të paguajë, nuk do të plotësojë ose nuk do të përmbushë asnjë pretendim, përgjegjësi, ose detyrim, përveç atyre që i përkasin aktivitetit të zakonshëm të biznesit të saj pa u këshilluar me blerësin kur këto shuma kalojnë vlerën prej 400,000 (katërqind mijë) lekësh;

xiv) Shoqëria nuk do të përfundojë, ndryshojë ose nënshkruajë ndonjë transaksion, ose as të ndryshojë ose përfundojë ndonjë transaksion, ose kontratë që mund të shkaktonë një ndryshim material përkeqësues mbi asetet, pronat, veprimtarinë e bizneseve të shoqërisë;

xv) Shoqëria nuk do të pësojë asnjë detyrim material ose përgjegjësi materiale ose ndryshim material përkeqësues;

xvi) Shoqëria do të fillojë procedurën e regjistrimit të aseteve e rrjetit të shoqërisë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, menjëherë pas lëshimit të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave mbi miratimin e listës së inventarit dhe urdhrin vijues të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për regjistrimin e pasurive në fjalë. Shitësi është i detyruar që të ushtrojë përpjekjet e veta maksimale me qëllim që të sigurojë regjistrimin e menjëhershëm, përpara datës së mbylljes, të çdo aseti të nevojshëm për veprimtarinë e shoqërisë, nëse shoqëria nuk figuron e regjistruar si pronare e ligjshme në datën e nënshkrimit. Nëse përpara datës së mbylljes, shoqëria nuk figuron e regjistruar si pronare e ligjshme e pasurive të listuara në shtojcën G, shitësi duhet të asistojë e të suportojë blerësin me qëllim që të realizohet regjistrimi përpara datës së mbylljes;

xvii) Shoqëria do të dorëzojë llogaritë mbi administrimin që nga data e krijimit deri në datën e mbylljes.

Brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e nënshkrimit, blerësi mund t'u komunikojë shitësit dhe shoqërisë emrat e përfaqësuesve të blerësit, numri i të cilëve mund të jetë deri në 5 (pesë) që do të kenë të drejtë të plotë aksesit në shoqëri dhe në aktivitetet e saj deri në mbyllje.

7.2 Shitësi do të ushtrojë përpjekjet e tij më të mira, me qëllim që të asistojë blerësin dhe shoqërinë, në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar në fuqi, që pas mbylljes:

i) të qartësohet plotësisht qëllimi i blerjes;

ii) autoritetet qeveritare nuk do të shkaktojnë dhe nuk do të zbatojnë asnjë nga rastet e mëposhtme: i) dënim, nacionalizim, rezukionim, urdhër komandues, konfiskim, blerje e detyrueshme, shpronësim i të gjitha ose të një pjese të aksioneve në shitje të shoqërisë, biznesit të saj, të pronave ose të licencave; ii) kujdestari apo kontroll i të gjitha ose të një pjese thelbësore të aksioneve në shitje të shoqërisë, të biznesit të saj, të pronave ose të licencave; ose iii) veprime për prishjen apo çregjistrimin e shoqërisë; ose iv) veprime që ndalojnë blerësin për të ushtruar aktivitetin e tij ose operacionet e biznesit apo ushtrimin e ndonjë pjese thelbësore të aktivitetit, siç kryhet aktualisht;

iii) për çdo shpërblim të punonjësve të shoqërisë në lidhje me largimin e tyre nga puna pas mbylljes, nëse ka, do të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

7.3 Shitësi, duke pasur parasysh se:

- është bërë remonti total i "HEC-it Lanabregas";

- duke marrë dhe në konsideratë gjendjen teknike dhe perspektivën e mundësinë për fuqizimin e rritjen e fuqisë instaluese e të prodhimit mbi bazën e kërkesës së blerësit, i jep blerësit të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të këtij burimi ujqor e të rezervuarit të “HEC Lanabregas”.

Neni 8

Premtimet e blerësit

8.1 Ruajtja e selisë ligjore

Blerësi do të ruajë selinë ligjore të shoqërisë.

8.2 Investimet dhe planbiznesi

Blerësi do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të zhvilluar aktivitetet e shoqërisë, me qëllim që ta bëjë këtë biznes konkurrues dhe efikas në treg, në përputhje me planin e tij të biznesit, siç përshkruhet në shtojcën M.

Pavarësisht nga sa më lart, në rast se investimet e propozuara nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur dhe në kohë për shkak të një rasti që del jashtë kontrollit të blerësit, e tillë si forca madhore apo çdo rast tjetër me të njëjta pasoja si kjo e fundit, si rrjedhojë blerësi nuk është i detyruar t'i paguajë ndonjë penalitet shitësit.

8.3 Titulli i pronësisë mbi aksionet

Blerësi do të zotërojë drejtpërsëdrejti ose indirekt shumicën e aksioneve të shoqërisë bashkë me të drejtat kontrolluese për të paktën 5 (pesë) vjet, duke filluar nga mbyllja, përveç rastit kur shitësi bie dakord ndryshe.

Në rast se aksionari i shoqërisë është shoqëri e re dhe palët e ortakërisë kanë për qëllim të transferojnë pjesët e tyre të kapitalit të shoqërisë së re ose të shoqërisë mëmë sipas rastit, palëve të treta, në tërësi apo pjesërisht, shitësi ka të drejtë të shprehë miratimin e tij në lidhje me përfituesin e propozuar të transferimit, të paktën për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, duke filluar nga data e mbylljes. Për këtë qëllim, palët e ortakërisë duhet t'i komunikojnë me shkrim shitësit identitetin e përfituesit të propozuar të transferimit dhe kushtet e transferimit. Shitësi do të shprehë miratimin e tij për përfituesin e propozuar të transferimit, brenda 20 (njëzet) ditëve, duke filluar që nga data e marrjes së këtij komunikimi, në të kundërt miratimi i shitësit do të konsiderohet i refuzuar. Transferimi i aksioneve pa pëlqimin e shitësit, do të konsiderohet nul dhe i pavlefshëm.

Blerësi ka të drejtën e zhvillimit të asetëve, të përfuara nga kjo blerje, për prodhimin e energjisë elektrike:

a) duke shtuar kapacitetet prodhuese në centralin ekzistues;

b) duke shtuar kapacitetet prodhuese nëpërmjet ndërtimit të centraleve të reja.

Blerësi merr përsipër që të sigurojë furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve, që furnizohen deri tani nga rrjeti shpërndarës i hidrocentralit dhe që kalojnë te blerësi.

Blerësi merr përsipër që të sigurojë furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve të rinj, duke bashkëpunuar me shoqërinë e shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas kapaciteteve të mundshme, për të cilat bihet dakord mes palëve.

Blerësi merr përsipër që të bashkëpunojë me “CEZ Shpërndarje” dhe me operatorin e sistemit të transmetimit, për të operuar në rrjetin rajonal të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Neni 9

Premtimet e përbashkëta të palëve

Palët heqin dorë nga çdo veprim dhe do të njoftojnë njëra-tjetrën menjëherë për çdo zhvillim, i cili mund të rrezikojë apo të vonojë përfundimin e transaksionit.

Palët do të ndihmojnë njëra-tjetrën në mënyrë të arsyeshme me qëllim që të përmbushin kushtet paraprake të parashikuara në këtë kontratë.

Palët bien dakord të ndryshojnë statutin e shoqërisë përpara mbylljes dhe të bien dakord bashkërisht për tekstin e ndryshimeve të propozuara përpara kësaj date, me qëllim që të parashikojnë në



statut: i) të drejtën e shitësit, të caktojë një anëtar të këshillit mbikëqyrës; ii) të drejtën e shitësit për të miratuar përfituesin e propozuar të transferimit; iii) të drejtën e shitësit të mbajë të njëjtën përqindje aksionesh, siç përcaktohet në kontratë, sipas neneve 4.3 dhe 8.3.

Blerësi dhe shitësi do t'i sigurojnë njëri-tjetrit çdo dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për përfundimin e transaksionit, përveç atyre që lidhen me forcat ushtarake, forcat policore, mbrojtjen kombëtare apo shërbimin informativ.

Blerësi do të ndërmarrë të gjitha veprimet brenda kompetencave të tij, që janë të nevojshme për përmbushjen e kushteve të përcaktuara në nenin 10 më poshtë.

Blerësi do të depozitojë menjëherë çdo kërkesë pranë çdo autoriteti qeveritar, duke përfshirë, për të evituar çdo dyshim, Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës, çdo kërkesë për miratim nga ana e organeve qeveritare apo njoftim që nevojitet për përmbushjen e transaksionit, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e nënshkrimit.

Shitësi do të ushtrojë përpjekjet e tij më të mira për të asistuar blerësin në procesin e depozitimit. Blerësi merr përsipër që t'i sigurojë çdo autoriteti qeveritar çdo dhe të gjithë informacionin e kërkuar dhe/ose dokumentacionin që lidhet me të.

Shitësi do të bashkëpunojë dhe do të mundësojë që shoqëria të bashkëpunojë me blerësin, ose të veprojë direkt, kur është e nevojshme apo sipas kërkesave të legjislacionit të zbatueshëm, për të përgatitur depozitimet që kërkojnë, pranë autoriteteve qeveritare, siç përcaktohet në nenin 10.1 më poshtë dhe do të mundësojë që shoqëria t'i sigurojë blerësit dokumentet dhe informacionin, të nevojshëm për qëllimet e depozitimit.

Palët bien dakord që të kontrollojnë së bashku përmbushjen e të gjitha kushteve të mbylljes me qëllimin që mbyllja të ndodhë në fund të muajit që palët mund të bien dakord. Për këtë qëllim në fund të muajit korrik do të organizohet një takim midis palëve.

Neni 10

Kushtet e mbylljes

Detyrimi i blerësit për të blerë aksionet në shitje dhe detyrimi i shitësit për t'i shitur aksionet në shitje blerësit, është i kushtëzuar nga përmbushja ose heqja dorë, në ose para datës së mbylljes së kushteve të mëposhtme:

10.1 Miratimet

Të gjitha miratimet, urdhrat ose aprovimet, deklarimet, depozitimet kur ka kaluar afati i nevojshëm i kohës së pritjes i vendosur nga ndonjë autoritet qeveritar ose ent, të nevojshme për realizimin e shitjes dhe të blerjes së aksioneve në shitje, do të jenë marrë ose depozituar nga shitësi ose do të kenë ndodhur, ose sipas rastit, autoriteti kompetent do të ketë hequr dorë prej tyre.

Në veçanti, Këshilli i Ministrave do të ketë lëshuar një vendim për miratimin e blerjes së aksioneve në shitje nga blerësi, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Shqipëri.

Këshilli i Ministrave do t'i ketë paraqitur këtë kontratë Kuvendit, dhe ky i fundit do ta ketë ratifikuar atë.

10.2 Mungesa e vendimeve për ndalimin ose kufizimin

Asnjë ligj i zbatueshëm ose vendim i miratuar, i shpallur në zbatim ose që është nxjerrë nga një autoritet qeveritar, as edhe ndonjë kufizim ose pengesë tjetër ligjore, që ndalojnë kryerjen e blerjes dhe të shitjes së aksioneve në shitje, nuk do të jetë në fuqi.

10.3 Kushtet për detyrimin e blerësit

Detyrimi i blerësit për të blerë aksionet në shitje dhe për të paguar për aksionet në shitje në mbyllje, është i kushtëzuar nga përmbushja (ose heqja dorë nga blerësi), në ose para datës së mbylljes, e kushteve të mëposhtme kur:

a) Deklarimet dhe garancitë e shitësit në këtë kontratë do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet thelbësore, që nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe në momentin e mbylljes, sikur të jenë kryer në këtë kohë, përveç rastit kur këto deklarata dhe garanci lidhen shprehimisht me një datë të mëparshme (rast në të cilin këto deklarata dhe garanci do të jenë të vërteta dhe të sakta në çdo kuptim

thelbësor, në dhe që nga kjo datë e mëparshme), përveç rasteve kur, veç e veç ose bashkërisht, duket, se nuk do të shkaktojnë një ndryshim material përkeqësues.

b) Shitësi do të ketë kryer ose përmbushur, në çdo aspekt thelbësor, të gjitha detyrimet dhe premtimet sipas kësaj kontrate, për t'u kryer ose përmbushur nga shitësi në datën e mbylljes, përveç rasteve kur, veç e veç ose bashkërisht, duket se, nuk do të shkaktojnë një ndryshim material përkeqësues.

c) Në datën e mbylljes nuk do të ketë asnjë proces të papërfunduar nëpërmjet të cilit kërkohet: i) kufizimi ose ndalimi i shitjes dhe i blerjes së aksioneve në shitje blerësit; ii) ndalimi ose kufizimi i titullit të pronësisë ose i funksionimit të shoqërisë nga shitësi; nga shoqëria apo të çdo pjese thelbësore të aktivitetit apo asetëve të shoqërisë; iii) të kufizohet aftësia e blerësit për të fituar ose për të zotëruar, ose për të ushtruar të drejta të plota të pronësisë mbi aksionet në shitje; apo iv) të ndalohet blerësi të kontrollojë në mënyrë efikase shoqërinë. Pavarësisht nga sa më sipër, do të konsiderohet se blerësi do të ketë hequr dorë nga ky kusht, si dhe nga çdo proces, padi apo procedim (përveç ndonjë procesi, padie apo procedimi nga ndonjë autoritet qeveritar) në rast se shitësi dëmshpërblen blerësin, në formën dhe në përmbajtjen e kënaqshme për këtë të fundit, në lidhje me këtë proces, padi apo procedim.

10.4 Kushtet për detyrimin e shitësit

Detyrimi i shitësit për të shitur, për të transferuar dhe për të dorëzuar aksionet në shitje është i kushtëzuar nga përmbushja (ose heqja dorë nga shitësi) në ose para datës së mbylljes, i kushteve të mëposhtme kur:

a) Deklarimet dhe garancitë e shitësit në këtë kontratë do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet thelbësore, që nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe në momentin e mbylljes, sikur të jenë kryer në këtë kohë, përveç rastit kur këto deklarata dhe garanci lidhen shprehimisht me një datë të mëparshme (rast në të cilin këto deklarata dhe garanci do të jenë të vërteta dhe të sakta në çdo kuptim thelbësor në dhe që nga kjo datë e mëparshme), përveç rasteve kur, veç e veç ose bashkërisht, duket se nuk do të shkaktojnë një ndryshim thelbësor përkeqësues.

b) Blerësi do të ketë kryer ose përmbushur, në çdo aspekt thelbësor, të gjitha detyrimet dhe angazhimet sipas kësaj kontrate, që duhet të kryhen ose të përmbushen në kohën e mbylljes.

c) Në datën e mbylljes nuk do të ketë asnjë proces të papërfunduar apo rast në proces nga ndonjë autoritet qeveritar në territorin e Shqipërisë (ose nga ndonjë person tjetër ndonjë çështje që ka mundësi të arsyeshme suksesi), me anë të të cilit kufizohet ose ndalohet shitja dhe blerja e aksioneve në shitje apo nëpërmjet të cilit kërkohet nga shitësi dëmshpërblim material në lidhje me shitësin lidhur me shitjen dhe blerjen e aksioneve në shitje; pavarësisht nga sa më sipër, shitësi do të konsiderohet se ka hequr dorë nga ky kusht, si dhe nga çdo proces, padi apo procedim (përveç ndonjë procesi, padie apo procedimi nga ndonjë autoritet qeveritar) në rast se blerësi nën diskrecionin e tij, dëmshpërblen shitësin, në formë dhe në përmbajtje të kënaqshme për këtë të fundit, në lidhje me këtë proces, padi apo procedim.

Neni 11

Dëmshpërblimi nga shitësi

11.1 Përgjegjësia e shitësit

Shitësi bie dakord dhe pranon të mos dëmtojë dhe do të dëmshpërblejë blerësin dhe/ose shoqërinë, sipas rastit, në përputhje me kushtet dhe brenda kufizimeve, të rëna dakord më poshtë, nga çdo humbje që rrjedh nga ose varet nga fakte ose rrethana që kanë ndodhur para datës së mbylljes, edhe nëse humbja verifikohet pas kësaj date.

Çdo dëmshpërblim që duhet të paguhet nga shitësi, sipas kësaj kontrate, do të bëhet i pagueshëm vetëm kur humbja përkatëse provohet me dokumente e evidenca të caktuara nga ana e blerësit dhe/ose shoqërisë ose do të jetë vendosur sipas një vendimi gjyqësor, vendim i gjykatës së arbitrazhit apo i ndonjë autoriteti qeveritar, përfshirë, por pa u kufizuar nga ERE, Autoritetin e Konkurrencës dhe autoritetet tatimore dhe do të jetë bërë e pagueshme.

Për qartësi, asnjë shkelje ose supozim për shkelje të një deklarimi, garancie apo pretendimi nga shitësi, nuk i jep të drejtë blerësit të dëmshpërblehet, përveç rastit kur kjo shkelje që i shkakton humbje blerësit dhe/ose shoqërisë provohet me dokumente e evidenca të caktuara nga ana e blerësit dhe/ose



shoqërisë ose do të jetë vendosur sipas detyrimeve të përcaktuara nga një vendim gjyqësor, vendim i gjykatës së arbitrazhit apo i ndonjë autoriteti qeveritar, përfshirë, por pa u kufizuar nga ERE, Autoritetin e Konkurrencës dhe autoritetet tatimore.

11.2 Përgjegjësia për dëmshpërblim në rast të shkeljes së garancive

Është rënë dakord që e drejta për të përfituar dëmshpërblim sipas kësaj dispozite nuk i heq të drejtën palëve të përfitojnë ndonjë kompensim, dëmshpërblim apo përfitim në lidhje me shkeljen e deklarimeve dhe garancive nga ana e palëve sikurse parashikohet në nenet 5 dhe 6.

11.3 Përgjashtimet dhe kufizimet

Detyrimi për dëmshpërblim i shitësit sipas kësaj kontrate, do të bëhet efektiv (i kërkueshëm) vetëm nëse shuma totale e humbjeve (dëmeve të shkaktuara blerësit dhe/ose shoqërisë), objekt i kërkesës për dëmshpërblim nga ana e blerësit, në total, kalon shumë prej 100,000 (njëqindmijë) eurosh ose vetëm nëse shuma e një humbjeje (dëmi të shkaktuar blerësit dhe/ose shoqërisë), objekt i kërkesës për dëmshpërblim nga ana e blerësit, kalon shumë prej 100,000 (njëqindmijë) eurosh, ose pavarësisht nga vlera monetare, humbja (dëmi) përfaqëson dëmtim të aktivitetit e veprimtarisë së blerësit dhe ose shoqërisë.

Në asnjë rast, shuma totale që do të paguhet nga shitësi si dëmshpërblim, në bazë të këtij neni, nuk do të kalojë 20% (njëzet për qind) të çmimit të blerjes.

Shuma, që duhet të paguhet nga shitësi sipas kësaj dispozite, do t'i paguhet blerësit brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas njoftimit që blerësi i kryen shitësit për humbjen që është bërë e kërkueshme për t'u paguar.

Në rast se shitësi vonon në kryerjen e kësaj pagese, mbi shumë që duhet të paguhet do të aplikohet interes i barabartë me koston ndërkombëtare të interesit të financimit, që llogaritet me një mesatare mujore prej 3 (tre) muaj EURIBOR, i përcaktuar nga Banka Qendrore Europiane. Interesi do të aplikohet deri në ditën që shitësi do të kryejë këtë pagesë. Në rast se edhe pas 90 (nëntëdhjetë) ditëve vonesë shuma nuk do të jetë paguar, blerësi, duke ruajtur çdo dhe të gjitha të drejtat e tij ligjore, ka të drejtë të kompensojë drejtpërsëdrejti pagesën e kësaj shume me ndonjë shumë që blerësi dhe/ose shoqëria duhet t'i paguajë shitësit. Kompensimi nuk mund të zbatohet në lidhje me pagesën e çmimit të plotë të blerjes. Në rastin e bërjes së kompensimit, shitësi, duke vepruar në mirëbesim, do të paraqesë çdo dhe të gjitha dokumentet dhe informacionin e nevojshëm për të siguruar që veprimet e kompensimit janë kryer në mënyrën dhe kohën e duhur. Shumës që duhet të paguhet nga shitësi sipas këtij neni, në lidhje me ndonjë kërkesë për dëmshpërblim, do t'i zbritet: i) çdo shumë që shoqëria mund të ketë përfituar nga ndonjë policë sigurimi në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate ose nga çdo palë e tretë lidhur me çështjen përkatëse që është objekt i kërkesës për dëmshpërblim për shoqërinë; ii) çdo përfitim nga taksat që ka përfituar blerësi ose shoqëria si rrjedhojë e një rasti që përbën shkak për dëmshpërblim.

Në çdo rast, shitësi nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi ndaj blerësit në lidhje me ndonjë shkelje të pretenduar të deklarimeve dhe të garancive, nëse shitësi nuk është njoftuar për shkeljen brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

11.4 E drejta dhe detyrimi i shitësit në lidhje me humbjet dhe pretendimet e palëve të treta

11.4.1 Përgjegjësia e shitësit ndaj pretendimeve të palëve të treta

Nëse ndaj blerësit dhe ose shoqërisë ngrihen pretendime të caktuara nga palët e treta, që kanë të bëjnë me fakte apo rrethana që kanë ndodhur përpara mbylljes, atëherë:

a) nuk do të merret përsipër asnjë përgjegjësi nga ana e blerësit dhe ose shoqëria, apo për llogari të tij, dhe pretendimi nuk do të negociohet, shlyhet apo zgjidhet pa miratimin paraprak me shkrim të shitësit, miratim i cili nuk duhet të mohohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme;

b) Shitësi ka të drejtë që të marrë pjesë, me shpenzimet e veta, në mbrojtjen e blerësit ndaj pretendimeve të palëve të treta. Në këtë rast, blerësi duhet t'i krijojë shitësit mundësinë për të dhënë opinionin e tyre dhe për të kundërshtuar në lidhje me mënyrën e mbrojtjes ndaj pretendimit. Blerësi duhet që, në mënyrë të arsyeshme, ta mbajë shitësin të informuar mbi ecurinë e pretendimeve të palëve të treta dhe mbrojtjes përkatëse, dhe sa më shpejt që të jetë e arsyeshme duhet që t'i japë shitësit kopjet e të gjitha njoftimeve, komunikimeve me shkrim dhe depozitimeve (përfshirë dokumentet e përdorura në gjykatë), të konsideruara thelbësore, të bëra nga, apo për llogari të palëve që janë subjekt të pretendimit

në fjalë.

11.4.2 Procedurat dhe afatet e njoftimit të fakteve që mund të shkaktojnë humbje

Blerësi bie dakord të njoftojë shitësin për çdo fakt që mund t'i shkaktojë shoqërisë një humbje, për dëmshpërblimin e së cilës shitësi mund të jetë përgjegjës menjëherë pas marrjes dijeni mbi faktet, dhe në çdo rast brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes dijeni, me kusht që nëse afati i fundit për depozitimin e një ankese ose kundërshtimi në lidhje me këtë humbje është më pak se 30 (tridhjetë) ditë, shitësi duhet të njoftohet në kohë nga blerësi, sipas afateve ligjore, me njoftim me shkrim, ku të përcaktohet pretendimi në detaje, bashkë me të gjithë dokumentacionin që ka në dispozicion, i cili mund të jetë i nevojshëm për të bërë të mundur që shitësi të kryejë veprimet e duhura në lidhje me humbjen, objekt i këtij pretendimi. Për qëllimet e këtij paragrafi, detyrimet e blerësit, për t'i njoftuar shitësit ndonjë fakt, i cili mund t'i çojë në një humbje për të cilën shitësi mund të konsiderohet përgjegjës dhe posaçërisht procedura e njoftimit 30-ditor (tridhjetëditor) do të nisnin pas një afati prej 45 ditësh (dyzet e pesë) nga data e mbylljes. Shitësi ka të drejtë të drejtojë menaxhimin e rrethanave, sipas rastit, të cilat janë shkak për ngritjen e pretendimeve nga ana e blerësit dhe blerësi bie dakord të sigurojë, sipas kërkesës së shitësit, se shoqëria: i) do të informojë rregullisht dhe në kohë shitësin për çdo njoftim, komunikim ose informacion tjetër që ka marrë në çdo lloj mënyre nga shoqëria, në lidhje me këtë pretendim; ii) do të bashkëpunojë me shitësin në lidhje me kompensimet dhe veprimet përkatëse, duke mundësuar që shitësi të përdorë të gjitha shënimet, dosjet dhe të dhënat që lidhen me to, dhe mbështetjen e nevojshme nga punonjësit e saj; dhe iii) do të bashkëpunojë me shitësin për kryerjen e procedurave ligjore dhe/ose zgjidhjen me mirëkuptim dhe/ose nismat e tjera në lidhje me to.

Në qoftë se shitësi nuk bashkëpunon brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit përkatës nga blerësi, me përjashtim të rasteve kur kërkohet bashkëpunimi i menjëhershëm nga shitësi me qëllim që të respektohen afatet ligjore, blerësi, pavarësisht nga sa më sipër, do të ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm, përfshirë këtu zgjedhjen e avokatëve dhe këshilltarëve të tij, të nevojshëm për të zvogëluar shumën që kërkohet si dëmshpërblim dhe do të mundësojë që shoqëria të ndërmarrë të gjitha veprimet e masat e nevojshme dhe të njoftojë menjëherë dhe në mënyrë të plotë shitësin për çdonjërin nga këto nisma apo veprime.

Nismat që ndërmerr blerësi apo shoqëria lidhur me këto pretendime, pa njoftuar rregullisht shitësin ose mospërmbushja nga shoqëria e parashikimeve të mësipërme të po këtij neni 11.4, nuk e shkarkon shitësin nga detyrimi i tij për të dëmshpërblyer në mënyrë të plotë blerësin në lidhje me pretendimin përkatës.

Shitësi është i detyruar të paguajë blerësin ose shoqërinë sipas këtij neni, vetëm nëse dhe kur humbja përkatëse do të bëhet e pagueshme, përfshirë këtu dhe shpenzimet gjyqësore, dhe tarifat përkatëse të avokatëve apo këshilltarëve.

Neni 12

Forca madhore

Mospërmbushja e detyrimeve sipas kësaj kontrate prej njëres nga palët, nuk do të quhet shkelje ose mospërmbushje e kësaj kontrate, në rast se kjo mospërmbushje vjen si pasojë e një force madhore, me kusht që pala e prekur nga kjo ngjarje: a) të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, përkujdesjen e duhur dhe masa të ndryshme të arsyeshme, për të përmbushur afatet dhe kushtet e kësaj kontrate; dhe b) të ketë njoftuar palën tjetër sa më shpejt të jetë e mundur për këtë ngjarje.

Çdo periudhë, brenda së cilës njëra nga palët sipas kësaj kontrate duhet të kryejë një veprim ose detyrë, do të zgjatet për një periudhë kohe të barabartë me periudhën, gjatë së cilës kjo palë nuk mund të kryejë këtë veprim për shkak të forcës madhore.

Neni 13

Zgjidhja e kontratës

Kjo kontratë mund të zgjidhet vetëm në rastet e mëposhtme:



a) me marrëveshje të përbashkët me shkrim ndërmjet shitësit dhe blerësit, duke hequr dorë nga transaksioni në çdo moment përpara datës së mbylljes;

b) nga blerësi, para datës së mbylljes, në rast se:

i) shitësi nuk përmbush detyrimet e tij sipas nenit 10.3, me kusht që të jenë përmbushur kushtet e nenit 10.1 dhe 10.2, dhe blerësi të ketë përmbushur detyrimet e tij, sipas nenit 10.4;

c) nga shitësi para mbylljes, në rast se:

i) blerësi kryen shkelje të rënda të deklarimeve dhe të garancive që parashikohen në nenin 6;

ii) blerësi nuk përmbush detyrimet e tij sipas nenit 10.4, me kusht që të jenë përmbushur kushtet që përcaktohen në nenin 10.1 dhe 10.2, dhe shitësi të ketë përmbushur detyrimet e tij sipas nenit 10.3.

Në rast se kjo kontratë zgjidhet sipas pikave “a”, “b” dhe “c” më sipër, asnjë palë nuk do të jetë përgjegjëse ndaj palës tjetër, përveç rastit kur kanë ndodhur shkelje të mëparshme në ose para datës së zgjidhjes së kësaj kontrate. Gjithashtu, nëse kjo kontratë zgjidhet nga shitësi sipas paragrafit “c”, garancia fillestare do të përfitohet nga ministria sipas kushteve që janë përcaktuar prej saj sipas procedurave përkatëse.

Zgjidhja e kësaj kontrate për çfarëdo arsye nuk shkarkon palën nga ndonjë përgjegjësi, që në momentin e zgjidhjes ka qenë e krijuar ose që mund të krijohet nga një veprim apo mosveprim para zgjidhjes së saj.

Neni 14

Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni

Kjo kontratë, rregullohet nga ligji shqiptar.

Çdo mosmarrëveshje, që lind në lidhje me vlefshmërinë, fuqinë, interpretimin, zbatimin e detyrueshëm dhe zgjidhjen e kësaj kontrate, do të zgjidhet me mirëkuptim; në të kundërt kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 15

Të ndryshme

15.1 Ndryshimet

Çdo shtesë, ndryshim, zgjidhje ose heqje dorë nga ndonjë prej dispozitave të kësaj kontrate, do të jetë e vlefshme vetëm në qoftë se bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga ose në emër të secilës palë.

Mosushtrimi ose vonesa në ushtrimin e një të drejte ose mase mbrojtjeje, që parashikohen në këtë kontratë ose nga ligji, nuk përbën heqje dorë nga e drejta ose masa e mbrojtjes, ose heqje dorë nga të drejta ose masa të tjera mbrojtjeje.

Mosushtrimi i vetëm ose i pjesëshëm i një të drejte ose mase mbrojtjeje që parashikohen në këtë kontratë ose nga ligji, nuk pengon ushtrimin e mëtejshëm të së drejtës ose masës mbrojtëse ose ushtrimin e një të drejte ose mase tjetër mbrojtëse.

15.2 Pavlefshmëria e pjesëshme

Nëse një pjesë e kësaj kontrate është apo bëhet e pavlefshme, apo e humbet fuqinë e saj detyruese, palët vazhdojnë t'i nënshtrohen efektit detyrues të pjesës tjetër të saj. Në këtë rast, pala përkatëse duhet që të zëvendësojë pjesën e pavlefshme apo që ka humbur fuqinë detyruese, me dispozita të vlefshme dhe me fuqi detyruese dhe qëllimi i të cilave, duke pasur parasysh përmbajtjen dhe qëllimin e kësaj kontrate, është maksimalisht i ngjashëm me qëllimin që kërkohet të arrihet me pjesën e pavlefshme apo që ka humbur fuqinë detyruese.

15.3 Njoftimet

Njoftimet ose komunikime të tjera sipas ose në lidhje me këtë kontratë (njoftimi), do të jenë:

- me shkrim;

- në gjuhën shqipe;

- do t'i dorëzohen ose dërgohen me postë rekomande me kthim përgjigjeje ose teleks ose faks, palës që duhet të marrë njoftimin në adresën e caktuar, këtu më poshtë ose në një adresë tjetër të specifikuar nga kjo palë.

Me përjashtim të rastit kur provohet se njoftimi është marrë më shpejt, njoftimi do të quhet i dhënë nëse:

- është dërguar me postë, 10 (dhjetë) ditë pune pas postimit të tij;
- është dërguar me teleks, kur merret përgjigja përkatëse konfirmuese për marrje të tij; dhe
- është dërguar me faks, kur konfirmimi i transmetimit të tij është regjistruar nga faksi i dërguesit.

Adresat janë:

Blerësi

- Emri i palës: Shoqëria “Ujësjellës-kanalizime” sh.a.

- Adresa: Tiranë

- Dërguar në vëmendje të: Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë Shitësi

- Emri i palës: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

- Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë

- Nr. faksi: +355 4 227 617

- Dërguar në vëmendje të: Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

15.4 Kalimi i të drejtave

Kjo kontratë është detyrim ligjor dhe në përfitim të palëve, trashëgimtarëve të tyre dhe personave të cilëve u kalojnë këto të drejta.

Blerësi nuk mund të kalojë dhe të transferojë të drejtat e tij sipas kësaj kontrate, në tërësi ose në veçanti, pa miratimin paraprak me shkrim të shitësit, miratim i cili nuk do të refuzohet pa arsye.

15.5 Kostot dhe taksat

Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë kontratë, secila palë do të paguajë shpenzimet e saj në lidhje me negocimin dhe hartimin e kësaj kontrate dhe të shtojcave të saj. Çdo dhe të gjitha shpenzimet noteriale për nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj kontrate do të paguhet nga shitësi.

15.6 Tërësia e kontratës

Kjo kontratë, së bashku me shtojcat bashkëlidhur, përbën marrëveshjen e plotë dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme (nëse ka) midis palëve që lidhet me objektin e kësaj kontrate.

Unë, noteri, pasi ua lexova palëve me zë të lartë këtë kontratë, të hartuar në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe, u binda se palët e gjejnë atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe e nënshkruajnë rregullisht, dhe unë vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit shqiptar.

PËR SHITËSIN
MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGETIKËS
Nasip Naço

PËR BLERËSIN
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Sahit Dollapi

SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme që i janë bashkëngjitur kësaj marrëveshjeje do të quhen si pjesë përbërëse e saj:

Shtojca A: Llogaritë e shoqërisë

Shtojca B: Licencat

Shtojca C: Lista e licencave për markat tregtare dhe patentat e shoqërisë

Shtojca D: Lista e marrëveshjeve të nënshkruara nga shoqëria, pas datës së fundit

Shtojca E: Lista e prokurimeve pas datës së fundit kontabël

Shtojca F: Raporti i organeve tatimore

Shtojca G: Raport në lidhje me çështjet gjyqësore në proces

Shtojca H: Lista e pasurive të paluajtshme të shoqërisë

Shtojca I: Lista e aseteve dhe e pajisjeve të shoqërisë (inventari)

Shtojca K: Vërtetim për likuidimin e detyrimeve të sigurimeve shoqërore



Shtojca L: Kontrata e huas e nënshkruar nga shoqëria
Shtojca M: Plani i biznesit i blerësit
Për të shmangur çdo dyshim, shitësi garanton dhe deklaron se përmbajtja e shtojcave të mësipërme është e vërtetë dhe e saktë dhe do të jetë e tillë dhe në datën e mbylljes.

LIGJ
Nr. 102/2012

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9918, DATË 19.5.2008 “PËR
KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Pikat 5, 36, 37 dhe 45 ndryshohen si më poshtë:

“5. “Facilitetet shoqëruese” janë ato shërbime shoqëruese, infrastruktura fizike dhe facilitete të tjera ose elemente të lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë dhe/ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe/ose shërbimi ose kanë potencial për ta bërë këtë, e që përfshijnë, ndërmjet të tjerash, ndërtesat ose hyrjen në ndërtesa, kabllot e ndërtesave, antenat, kullat dhe ndërtime të tjera mbështetëse, kanalizime, tubacione, shtylla, puseta dhe kabinete.

¹ Ky ligj është përafëruar plotësisht me:

Direktivën 2009/140/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 25 nëntor 2009, e cila amendon Direktivën 2002/21/KE “Mbi një kuadër të përbashkët rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike”, Direktivën 2002/19/KE “Mbi aksesin dhe interkonieksionin e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese” dhe Direktivën 2002/20/KE “Mbi autorizimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike”, Numri CELEX: 32009L0140, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 337, datë 18.12.2009, faqe 37 – 69.

Direktivën 2009/136/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 25 nëntor 2009, e cila amendon Direktivën 2002/22/KE “Mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike”, Direktivën 2002/58/KE, lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e Komunikimeve Elektronike, Numri CELEX: 32009L0136, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 337, datë 18.12.2009, faqe 11–36.

Direktivën 2006/24/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 15 mars 2006, “Mbi mbajtjen e të dhënave të krijuara ose të përpunuara lidhur me ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun ose të rrjeteve të komunikimit publik” dhe që amendon Direktivën 2002/58/KE, Numri CELEX 32006L0024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 105, datë 13.4.2006, faqe 54–63.

36. “Rrjet i komunikimeve elektronike” janë sistemet e transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, përfshirë elementet e rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse tokësore (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kablllove elektrike, në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe rrjetet kablllore televizive, pavarësisht nga tipi i informacionit të përcjellë.

37. “Rrjet i komunikimeve publike” është një rrjet i komunikimeve elektronike, që përdoret, tërësisht ose kryesisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun dhe që suporton transferimin e informacionit ndërmjet pikave fundore të rrjetit.

45. “Shërbim telefonik i disponueshëm për publikun” është një shërbim i disponueshëm për publikun për origjinimin dhe marrjen direkte ose indirekte të thirrjeve kombëtare, apo kombëtare e ndërkombëtare, nëpërmjet një ose më shumë numrave në një plan numeracioni telefonik kombëtar ose ndërkombëtar.”.

2. Pas pikës 59 shtohen pikat 60 deri në 66 me këtë përmbajtje:

“60. “Organi i Rregullatorëve Europianë për Komunikimet Elektronike (BEREC)” është organi i krijuar nga Rregullorja (KE) nr. 1211/2009 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të 25 nëntorit 2009.

61. “Përcaktimi i një brezi frekuencash” është destinimi i një brezi të dhënë frekuencash në Planin Kombëtar të Frekuencave, me qëllim përdorimi nga një ose më shumë shërbime radio-komunikimi, sipas kushteve specifike.

62. “Caktimi i frekuencave” është dhënia e autorizimit për përdorimin e një frekuence apo kanali frekuence, sipas kushteve specifike.

63. “Pëlqim i subjektit të të dhënave” është çdo deklaratë me vullnet të plotë e të lirë, e dhënë shprehimisht dhe në dijeni të plotë për çfarë të dhënash do të përpunohen, me të cilën nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënash e tij.

64. “Skedar” është një bashkësi të dhënash të ndërlidhura mes tyre, që ruhen në një pajisje ruajtje të dhënash elektronike.

65. “Shërbime shoqëruese” janë ato shërbime të lidhura me një rrjet të komunikimeve elektronike dhe/ose një shërbim të komunikimeve elektronike, të cilat mundësojnë dhe/ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe/ose shërbimi ose kanë potencial për ta bërë këtë, dhe që përfshijnë, ndërmjet të tjerash, përkthimin e numrave ose sistemet e ofrimit të funksionalitetit ekuivalent, sistemet e aksesit të kushtëzuar dhe udhëzuesit e programit elektronik, gjithashtu, shërbime të tjera të tilla, si shërbimet e identitetit, vendndodhjes dhe prezencës.

66. “Cenim i të dhënave personale” është çdo cenim i sigurisë që çon në shkatërrimin, humbjen, ndryshimin ose shpërndarjen e paautorizuar, aksidentale apo të paligjshme ose aksesit në të dhënash personale të transmetuara, të ruajtura ose të përpunuara, në lidhje me ofrimin e një shërbimi të komunikimeve elektronike të disponueshëm për publikun.”.

Neni 2

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3, pas fjalës “Harton” shtohen fjalët “dhe paraqet në Këshillin e Ministrave”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Mund të nxjerrë urdhra dhe udhëzime me karakter normativ për çështje që lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe politikave të zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.”.

3. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. Bazuar në propozimet e AKEP-it, miraton kufizimet e mundshme për dhënien e frekuencave, procedurat përkatëse të konkurrimit publik, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave dhe vlerën minimale për dhënien e tyre.”.

4. Pikat 12 dhe 13 shfuqizohen.



Neni 3

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. AKEP-i ushtron funksionet në përputhje me parimin e ligjshmërisë, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera normative, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike e me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku Republika e Shqipërisë është palë. AKEP-i merr parasysh rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit European dhe BEREC-it.”.

2. Në pikën 3, shkronja “a” riformulohet si më poshtë:

“a) për t’u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me aftësi të kufizuara, të kenë përfitime maksimale nga aksesit në shërbimet e komunikimeve elektronike, në kuptimin e zgjedhjes së çmimit dhe cilësisë.”.

Neni 4

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “c”, fjalët “si dhe tarifa jo më të larta se tarifa mesatare e vendeve të BE-së” zëvendësohen me fjalët “si dhe tarifa të orientuara në kosto”.

2. Në shkronjën “n”, pas fjalëve “dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” shtohen fjalët “si dhe mosmarrëveshjet ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve”.

3. Shkronja “r” shfuqizohet.

4. Pas shkronjës “sh” shtohen shkronjat “t”, “th”, “u” dhe “v” me këtë përmbajtje:

“t) përcakton rregullat për funksionimin e shërbimit të radiondërlidhjes bregdetare;

th) përcakton rregullat dhe kërkesat teknike për funksionimin e shërbimeve radioamatore në Republikën e Shqipërisë;

u) siguron disponueshmërinë e një baze qendrore të dhënash për portabilitetin e numrit;

v) përcakton masa për rregullimin e tarifave, si dhe çmimet maksimale që mund të aplikohen në një seri të caktuar të numrave të përdorur për shërbimet me vlerë të shtuar, premium, me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve.”.

Neni 5

Në nenin 9 pika 2 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Fjalët “tremujorit të parë” zëvendësohen me fjalët “katër muajve të parë”.

b) Në fund të pikës shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Një kopje e raportit i dërgohet ministrit.”.

Neni 6

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Sipërmarrësi i autorizuar, sipas këtij neni, ka të drejtë:

a) të ofrojë rrjete apo shërbime të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë;

b) të aplikojë për marrjen e së drejtës së instalimit të facilitetve të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Kur një sipërmarrës i autorizuar, sipas këtij neni, ofron rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike për publikun, atëherë autorizimi i përgjithshëm i jep të drejtë:

a) të negociojë për interkoneksion dhe, kur është e zbatueshme, për të marrë akses nga sipërmarrësit e tjerë të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve të disponueshme për publikun, në përputhje me këtë ligj;

b) të marrë pjesë në përcaktimin si ofrues i shërbimit universal për shërbime të veçanta në skemën e shërbimit universal ose në pjesë të caktuara të territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 7

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, paragrafi i parë riformulohet si më poshtë:

“Njoftimi i sipërmarrësit bëhet me shkrim, sipas rregullave të miratuara nga AKEP-i, dhe duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:”

2. Në pikën 5, fjalët “AKEP-i regjistron operatorët ose ofruesit e shërbimit brenda 15 ditëve” zëvendësohen me fjalët “AKEP-i regjistron sipërmarrësit brenda 7 ditëve”.

3. Pika 6 riformulohet si më poshtë:

“6. Brenda 7 ditëve nga data e marrjes së një njoftimi jo të plotë në dokumentacion, sipas kërkesave në pikat 2 e 3 të këtij neni, AKEP-i informon sipërmarrësin për nevojën e plotësimit të informacionit të munguar. Nëse sipërmarrësi nuk e plotëson informacionin e munguar brenda 15 ditëve, AKEP-i informon sipërmarrësin se nuk do ta regjistrojë atë. Sipërmarrësi ka të drejtë të ankohet në Këshillin Drejtues të AKEP-it për këtë çështje.”.

4. Në pikën 7, fjala “dokumentacion” zëvendësohet me fjalën “informacion”.

5. Në fjalinë e fundit të pikës 9 hiqen fjalët “për të mundësuar aksesin në distancë”.

Neni 8

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në paragrafin e parë bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Paragrafi i parë bëhet pika 1 e këtij neni.

b) Në fund të shkronjës “dh” shtohen fjalët “duke përfshirë sigurimin e aksesit për përdoruesit me aftësi të kufizuara”.

c) Shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:

“e) respektimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme, sipas rregullimeve përkatëse ligjore në fuqi;”.

ç) Pas shkronjës “l” shtohen shkronjat “ll” dhe “m” me këtë përmbajtje:

“ll) përdorimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit nga autoritetet publike, për të paralajmëruar publikun për kërcënimet e pashmangshme nga katastrofat e mëdha dhe për zbutjen e pasojave nga katastrofat e mëdha;

m) detyrimet e operatorëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike që ofrojnë komunikimin ndërmjet pikave fundore të rrjetit për transparencë dhe informim për kufizimet e aksesit ose të përdorimit të shërbimeve, aplikimeve në rastin e zbatimit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 2 dhe 3 me këtë përmbajtje:

“2. Kushtet e vendosura nga AKEP-i, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jenë jodiskriminuese, proporcionale, transparente, të justifikuara për rrjetin ose shërbimin në fjalë dhe nuk duhet të dublojnë kushte që aplikohen ndaj sipërmarrësve nga akte të tjera ligjore në fuqi. Autorizimi i përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve dhe/ose rrjeteve të komunikimeve elektronike është subjekt i kushteve, sipas rregullores së miratuar nga AKEP-i.

3. Në rastin e përdorimit të frekuencave, sipërmarrësit duhet të përmbushin kushtet e përdorimit të frekuencave, sipas përcaktimeve në kreun VII të këtij ligji. Në rastin e përdorimit të numrave sipërmarrësit duhet të përmbushin kushtet, sipas përcaktimeve në kreun IX të këtij ligji, si dhe parimet e përcaktuara nga AKEP-i për tarifatat dhe çmimet maksimale që mund të aplikohen në një seri të caktuar numerike.”.



Neni 9

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

Detyrimi për të dhënë informacion

1. Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike janë të detyruar t'i japin AKEP-it, me kërkesë të tij, çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur detyrimet funksionale të AKEP-it, sipas këtij ligji.

2. Në veçanti, AKEP-i mund të kërkojë informacion, duke përfshirë informacione financiare, të cilat janë të nevojshme për:

a) verifikimin sistematik ose rast pas rasti të pajtueshmërisë me dispozitat e këtij ligji;

b) për procedurat dhe vlerësimin e kërkesave për dhënie të drejtave të përdorimit;

c) publikimin e përmbledhjeve krahasuese të cilësisë dhe çmimeve të shërbimeve në interes të përdoruesit;

ç) qëllime statistikore, në përputhje me legjislacionin në fuqi ose që rrjedhin nga marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe organizatave ndërkombëtare;

d) informacion lidhur me zhvillimet e ardhshme të rrjeteve ose shërbimeve që mund të kenë ndikim në shërbimet me shumicë, të cilat sipërmarrësit ua ofrojnë konkurrentëve; dhe

dh) analizën e tregjeve, në përputhje me kreun VI të këtij ligji. Sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg për tregjet me shumicë, gjithashtu, mund t'u kërkohej të paraqesin të dhënat e kontabilitetit për tregjet me pakicë, të cilat shoqërohen me ato të tregjeve me shumicë.

3. Sipërmarrësit ofrojnë informacionin, sipas kërkesës e në përputhje me afatet kohore dhe nivelin e detajeve të kërkuara nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të parashikuara në rregulloren përkatëse. Në rast mosparaqitjeje të informacionit të kërkuar, AKEP-i zbaton përcaktimet e paragrafëve VI dhe VII të nenit 137 të këtij ligji.

4. Informacioni i kërkuar nga AKEP-i do të jetë proporcional me përmbushjen e detyrave funksionale, për të cilat është kërkuar, dhe AKEP-i do të japë arsyet për të cilat ky informacion është kërkuar.

5. Nëse informacioni është vlerësuar si konfidencial, AKEP-i e siguron atë në përputhje me legjislacionin në fuqi për sekretin tregtar të biznesit. Nëse informacioni nuk është konfidencial, AKEP-i e publikon ose e vë në dispozicion të publikut, sipas kërkesës së tij, kur kjo është e nevojshme për të krijuar një treg të hapur dhe konkurrues. Nëse konfidencialiteti i informacionit është i diskutueshëm, AKEP-i vendos për konfidencialitetin pasi të ketë dëgjuar sipërmarrësin, vlerësuar interesat e sipërmarrësit për të trajtuar informacionin si konfidencial, si dhe interesat e publikut për të krijuar një treg të hapur dhe konkurrues.

6. Sipërmarrësit, të cilët ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike, janë të detyruar t'i paraqesin ministrit, me kërkesë të tij, të gjithë informacionin e nevojshëm për të përmbushur detyrat funksionale të ministrit, sipas këtij ligji. Ministri nxjerr udhëzim për të dhënat statistikore që raportohen pranë tij.”.

Neni 10

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

Disponueshmëria e shërbimit universal

1. Shërbimet e përfshira në shërbimin universal, sipas këtij ligji, duhet të jenë të disponueshme për përdoruesit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendndodhjes gjeografike, 8064

me cilësinë dhe kushtet e përcaktuara në aktin rregullator të nxjerrë nga AKEP-i, dhe me çmim të përballueshëm, në përputhje me kushtet specifike kombëtare.

2. AKEP-i, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për shërbimin universal, merr masat e duhura rregulluese, bazuar në parimet e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit, për garantimin e ofrimit të shërbimit universal, të përmendur më sipër, me sa më pak dëmtime të mundshme të tregut, në veçanti nga ofrimi i shërbimeve me çmime, terma dhe kushte të tjera nga ato të ofruara nga tregu për qëllim të interesit publik.”.

Neni 11

Pas nenit 25 shtohen nenet 25/1, 25/2, 25/3 dhe 25/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/1

Sigurimi i aksesit nga një vendndodhje fikse dhe ofrimi i shërbimit telefonik

1. Çdo kërkesë e arsyeshme për lidhje me rrjetin e komunikimeve publike në një vendndodhje fikse duhet të mundësohet nga, të paktën, një sipërmarrës. AKEP-i merr masat e duhura rregullatore për përmbushjen e këtij detyrimi nga ofruesi/t e caktuar për ofrimin e shërbimit universal.

2. Lidhja e ofruar me rrjetin e komunikimeve publike duhet t’i krijojë përdoruesit mundësi:

a) të bëjë dhe të marrë thirrje lokale, kombëtare e ndërkombëtare;

b) komunikimin me faks;

c) komunikimin e të dhënave me një shpejtësi të kënaqshme për të lejuar aksesin funksional të internetit, duke marrë parasysh teknologjitë mbizotëruese të përdorura nga shumica e pajtimtarëve dhe mundësitë e realizimit teknologjik.

Neni 25/2

Sigurimi i numërorit telefonik dhe rubrika e informimit për numrat

1. Ofrimi i shërbimit universal duhet të garantojë që:

a) të paktën, një numëror telefonik i përgjithshëm të jetë i disponueshëm për përdoruesit fundorë, sipas formatit të miratuar nga AKEP-i, në formë të printuar ose elektronike, si dhe të përditësohet rregullisht, të paktën, një herë në vit;

b) të paktën, një shërbim i informacionit për numrat telefonikë të përgjithshëm të jetë i disponueshëm për të gjithë përdoruesit fundorë, përfshirë përdoruesit e telefonave me pagesë.

AKEP-i merr masat e duhura rregullatore për përmbushjen e këtij detyrimi.

2. Numërori Telefonik i Përgjithshëm dhe shërbimi i informacionit për numrat duhet të repektojë kërkesat e këtij ligji për mbrojtjen e privatësisë në komunikimet elektronike dhe të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Sipërmarrësi/t, që ofrojnë shërbimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, zbatojnë parimin e mosdiskriminimit në trajtimin e informacionit të dhënë nga sipërmarrësit e tjerë.

Neni 25/3

Telefonat publikë me pagesë dhe pikat e tjera të aksesit publik telefonik

1. AKEP-i mund të imponojë detyrime ndaj sipërmarrësve, me qëllim që telefonat publikë me pagesë ose pika të tjera të aksesit publik telefonik të ofrohen duke plotësuar nevojat e arsyeshme të përdoruesve fundorë në termat e mbulimit gjeografik, numrit të telefonave ose pikave të aksesit, aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar dhe cilësisë së shërbimit.

2. AKEP-i, mbi bazën e një konsultimi me palët e interesuara, mund të vendosë të mos imponojë detyrime, sipas pikës 1 të këtij neni, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose në pjesë të tij, nëse këto shërbime ose të tjera të krahasueshme janë gjerësisht të disponueshme.



3. Telefonat publikë me pagesë duhet të mundësojnë thirrjen drejt numrit 112 dhe numrave të tjerë të emergjencës pa pagesë dhe pa qenë nevoja e përdorimit të mjetit të pagesës, të parashikuar për to.

Neni 25/4

Masat për përdoruesit me aftësi të kufizuar

1. AKEP-i vendos kushte për sigurimin e kushteve për akses të barasvlershëm dhe përdorimin e shërbimeve telefonike të disponueshme për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, duke përfshirë akses në shërbimet e thirrjeve të emergjencës dhe për informimin në numërorin telefonik për të gjithë përdoruesit në Republikën e Shqipërisë.

2. AKEP-I, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për përfshirjen sociale, bën vlerësimin për nevojat e përgjithshme dhe kërkesat specifike, duke përfshirë masën dhe formën konkrete të këtyre masave specifike për personat me aftësi të kufizuar.”.

Neni 12

Në nenin 26 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. AKEP-i mund të përcaktojë një ose më shumë sipërmarrës për të garantuar ofrimin e shërbimit universal, sipas përcaktimeve të nenit 25 të këtij ligji, përfshirë, për aq sa është e zbatueshme, kërkesat e pikës 3 të nenit 27 të këtij ligji, në mënyrë që i gjithë territori i vendit të jetë i mbuluar. AKEP-i mund të përcaktojë sipërmarrës të ndryshëm ose një bashkim sipërmarrësish për ofrimin e elementeve të ndryshme të shërbimit universal dhe/ose për mbulimin e pjesëve të ndryshme të territorit të vendit.”.

2. Pika 2 shfuqizohet.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Rregullat për përcaktimin e ofruesit/esve të shërbimit universal miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit. Në procesin e përcaktimit të një ose më shumë ofruesve të shërbimit universal, AKEP-i respekton parimet e efektivitetit, të objektivitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit. Asnjë sipërmarrës nuk është i përjashtuar paraprakisht nga e drejta për të qenë ofrues i shërbimit universal.”.

4. Pika 4 shfuqizohet.

5. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. AKEP-i kryen procedurën e përcaktimit të ofruesit/esve të shërbimit universal, sipas rregullave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, duke marrë në konsideratë:

a) rrethanat dhe zhvillimin e tregut të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, lidhur me nevojën e zbatimit të shërbimit universal;

b) aftësitë teknike, financiare dhe besueshmërinë e sipërmarrësit/ve për sigurimin e shërbimit universal në një zonë të caktuar ose gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, brenda periudhës kohore të përcaktuar;

c) kostot përkatëse neto për ofrimin e shërbimit universal, si dhe, për sa është e zbatueshme, vlerën korresponduese të kompensimit, që mund të kërkohet nga operatori për ofrimin e shërbimit universal.”.

6. Në pikën 6, fjalët “së tenderit” zëvendësohen me fjalët “së përcaktimit”.

7. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Kur një ofrues i shërbimit universal ka për qëllim të zhvendosë një pjesë të konsiderueshme ose të gjitha asetet e rrjetit të tij të aksesit lokal në një person juridik në pronësi tjetër, duhet të informojë paraprakisht AKEP-in, në mënyrë që t'i mundësojë AKEP-it të vlerësojë efektet e transaksionit të synuar në ofrimin e aksesit në vendndodhje fikse dhe të shërbimeve telefonike, sipas nenit 25/1 të këtij ligji. AKEP-i mund të vendosë, të ndryshojë ose të heqë detyrimet e veçanta, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.”.

Neni 13

Në nenin 27 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. AKEP-i monitoron ndryshimet dhe nivelin e tarifave të shërbimeve, të përcaktuara në nenet 25/1 deri në 25/4 dhe pikës 3 të këtij neni, të ofruara nga ofruesi/t e shërbimit universal ose nga tregu, nëse nuk kemi ofrues të shërbimit universal të caktuar.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ofruesit e shërbimit universal mund të ofrojnë tarifa opsionale, paketa tarifore të veçanta dhe mënyra pagese të veçanta për pajtimtarët me të ardhura të pakta dhe/ose për pajtimtarët me nevoja të veçanta, në mënyrë që këta pajtimtarë të mos jenë përjashtuar nga aksesit në rrjet dhe përdorimi i shërbimeve të përcaktuara në këtë kre.”.

3. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. AKEP-i detyron ofruesit e shërbimit universal t’u ofrojnë pajtimtarëve të tyre mundësinë për të përdorur shërbimet e mëposhtme:

a) bllokimin me zgjedhje dhe pa pagesë të thirrjeve dalëse a mesazheve të shkurtra SMS me vlerë të shtuar ose MMS-ve apo, kur është teknikisht e mundur, të shërbimeve të tjera të ngjashme;

b) sistemet e parapagimit, për të pasur akses në rrjetet e komunikimit elektronik publik dhe përdorimit të shërbimeve telefonike të vlefshme për publikun;

c) pagesa të shtrira në kohë për tarifën e lidhjes në rrjetin e komunikimit elektronik publik;

ç) këshilla për tarifën, ku pajtimtarët mund të kërkojnë që sipërmarrësi t’i informojë për tarifa të tjera alternative me kosto më të ulët, nëse janë të disponueshme;

d) mundësinë e kontrollit të shpenzimeve të komunikimeve, duke përfshirë njoftimin paralajmërues pa pagesë të pajtimtarit, në rastin kur këto shpenzime janë shumë më të larta se shpenzimet normale të tij;

dh) mundësinë e verifikimit dhe të kontrollit të shpenzimeve të kryera nga përdorimi i rrjetit publik të komunikimeve nga një vendndodhje fikse dhe/ose shërbimet telefonike të disponueshme për publikun.”.

Neni 14

Në nenin 29, pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Ofruesit e shërbimit universal kanë të drejtë të kërkojnë kompensim, nëse ofrimi i shërbimit, sipas neneve 25/1 deri në 25/4 dhe nenit 27 pika 3 të këtij ligji, përbëjnë një ngarkesë të padrejtë dhe krijojnë kosto shtesë. Nëse AKEP-i arrin në përfundimin se ofrimi i këtyre shërbimeve mund të përbëjë një ngarkesë të padrejtë për sipërmarrësin/it e përcaktuar për ofrimin e shërbimit universal, AKEP-i llogarit koston neto për ofrimin e këtij shërbimi.”.

Neni 15

Në nenin 34, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Detyrimet e vendosura në përputhje me këtë nen bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe duhet të jenë proporcionale e të justifikuara nga pikëpamja e objektivave rregullatore të vendosura në nenin 7 të këtij ligji.”.

Neni 16

Në nenin 42 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, shkronjat “a” dhe “g” ndryshohen si më poshtë:

“a) t’u ofrojnë palëve të treta akses në elemente të veçanta të rrjetit dhe/ose faciliteteve, duke përfshirë akses në elemente të rrjetit, të cilat nuk janë aktive dhe/ose akses të hapur në qarkun lokal,



duke lejuar, ndërmjet të tjerash, zgjedhjen dhe/ose parazgjedhjen e bartësit dhe/ose ofertat e rishitjes së linjës së pajtimtarit;”.

“g) të ofrojë akses në shërbimet shoqëruese.”.

2. Në pikën 3, në fund të shkronjës “a” shtohen fjalët “përfshirë mundësinë e aksesit në produkte të tjera të një niveli më të lartë, si aksesin në tubacione.”.

Neni 17

Në nenin 47 pika 1 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Fjalët “kundrejt pagesës” hiqen.

b) Fjalët “nga data e marrjes së saj” zëvendësohen me fjalët “nga data e marrjes së një kërkesë”.

Neni 18

Në nenin 49 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Pavarësisht nga masat që mund të merren ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, në përputhje me nenin 34 të këtij ligji, AKEP-i vendos:

a) ndaj sipërmarrësve, të cilët kontrollojnë aksesin te përdoruesit fundorë, detyrimin në masën e duhur, për të siguruar lidhjen pikë fundore – pikë fundore, duke përfshirë, në rastet e justifikuara, detyrimin për të interkonektuar rrjetet e tyre në mungesë të këtij interkoneksioni;

b) në rastet e justifikuara dhe në masën e duhur, detyrimin ndaj sipërmarrësve, të cilët kontrollojnë aksesin te përdoruesit fundorë për të mundësuar ndërveprueshmërinë e këtyre shërbimeve.”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

“3. Detyrimet dhe kushtet e vendosura në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni duhet të jenë objektive, transparente, proporcionale dhe jodiskriminuese, si dhe të vendosura pas konsultimit publik, në përputhje me nenin 110 të këtij ligji.

4. AKEP-i ndërhyt me nismën e tij, kur është e justifikuar, në përputhje me objektivat e nenit 7 të këtij ligji ose me kërkesë të cilësdo palë, në përputhje me nenet 50 dhe 60 të këtij ligji.”.

Neni 19

Në nenin 52 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Fjala “publikon” zëvendësohet me fjalët “paraqet për miratim në AKEP”.

b) Në fund të pikës shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

“Jo më vonë se 90 ditë nga paraqitja e ofertës së referencës, AKEP-i e miraton atë ose imponon ndryshime, sipas pikës 3 të këtij neni. Në rast se brenda këtij afati AKEP-i nuk shprehet, miratimi konsiderohet i dhënë.”.

2. Në pikën 4, fjala “urdhri” zëvendësohet me fjalën “vendimi”.

3. Në paragrafin I pika 7 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “a” bëhen ndryshimet si më poshtë:

i) Në nënshkronjat “i” dhe “ii”, pas fjalës “akses” shtohet fjala “i hapur”.

ii) Pas nënshkronjës “ii” shtohet nënshkronja “iii” me këtë përmbajtje:

“iii) kur është e përshtatshme akses në tubacione për të mundësuar shtrirjen e rrjeteve të aksesit.”.

b) Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) informacioni për vendndodhjet e aksesit fizik, duke përfshirë kabinetet dhe permutatorët, disponueshmërinë e rrjeteve lokale, nënlokale dhe rrjeteve mbështetëse në pjesë të veçanta të aksesit në rrjet dhe, kur është e nevojshme, informacion lidhur me vendndodhjet e tubacioneve dhe disponueshmërinë brenda tubacioneve;”.

c) Në shkronjën “c”, në fund të fjalisë shtohen fjalët:
“dhe/ose fibrave optike, dhe/ose të ngjashme, shpërndarësve të kablove apo faciliteteve shoqëruese dhe, kur është e nevojshme, kushtet teknike lidhur me aksesin në tubacione.”.

4. Në paragrafin II pika 7, shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) informacion për vendndodhjen ekzistuese të godinave apo pajisjeve përkatëse të sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg ose vendndodhjen e pajisjeve dhe planet për përditësimin e tyre;”.

Neni 20

Në nenin 60 bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në nen, fjala “urdhri” zëvendësohet me fjalën “vendimi”.

2. Në pikën 1, fjala “urdhëron” zëvendësohet me fjalët “merr vendim për”.

Neni 21

Në nenin 62 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3 shkronja “b”, fjalët “për transmetimet radiodifuzive (radio dhe televizive)” zëvendësohen me fjalët “për transmetimet radio dhe televizive”.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Për përdorimin e frekuencave, përdoruesit civilë paguajnë një tarifë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për taksat në Republikën e Shqipërisë. Niveli i tarifës do të reflektojë nevojën për të garantuar një përdorim optimal të radiofrekuencave, si një burim i fundëm dhe duhet justifikuar në mënyrë objektive, transparente, jodiskriminuese e proporcionale në raport me qëllimin e tyre.”.

3. Pas pikës 4 shtohen pikat 5 deri në 12 me këtë përmbajtje:

“5. Administrimi i spektrit duhet të sigurojë që të gjitha llojet e teknologjisë së përdorur për shërbimet e komunikimeve elektronike dhe të gjitha llojet e shërbimeve të komunikimeve elektronike mund të përdoren në brezat e radio frekuencave të përcaktuara në Planin Kombëtar të Frekuencave, të vlefshme për shërbimet e komunikimeve elektronike.

6. Pavarësisht nga sa përcaktohet në pikën 5 të këtij neni, Plani Kombëtar i Frekuencave dhe Plani për Përdorimin e Frekuencave mund të parashikojnë kufizime proporcionale dhe jodiskriminuese për llojet e rrjeteve radio ose teknologjisë së aksesit pa tela, të përdorur për shërbimet e komunikimeve elektronike, kur kjo është e nevojshme:

a) për të parandaluar interferencat e dëmshme;

b) për të mbrojtur shëndetin publik nga fushat elektromagnetike;

c) për të siguruar cilësinë teknike të shërbimit;

ç) për të siguruar maksimizimin e përdorimit të frekuencave që bashkëpërdoren;

d) për ruajtjen dhe përdorimin efikas të spektrit; ose

dh) për të siguruar përmbushjen e objektivave me interes të përgjithshëm, në përputhje me pikën 7 të këtij neni.

7. Pavarësisht nga sa përcaktohet në pikën 5 të këtij neni, Plani Kombëtar i Frekuencave dhe Plani për Përdorimin e Frekuencave mund të parashikojnë kufizime proporcionale dhe jodiskriminuese për llojet e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të cilat do të ofrohen kur kjo është e nevojshme, për të siguruar përmbushjen e objektivave me interes të përgjithshëm, siç janë:

a) përmbushja e kërkesave të Radio Rregulloreve të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU);

b) siguria për jetën;

c) promovimi i një bashkëveprimi social, rajonal ose territorial;

ç) parandalimi i përdorimit joefikas të radiofrekuencave; ose

d) promovimi i larmisë kulturore, gjuhësore dhe shumëllojshmërisë së mediave, për shembull, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të transmetimeve radiotevizive.



8. Përcaktimet e pikës 5 të këtij neni zbatohen për frekuencat që do të caktohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

9. Për një periudhë pesëvjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, AKEP-i mund të lejojë mbajtësit e autorizimeve individuale për frekuencat e dhëna para hyrjes në fuqi të këtij ligji, të paraqesin aplikim pranë AKEP-it për rivlerësimin e kufizimeve, sipas pikës 5 të këtij neni.

10. AKEP-i njofton, me shkrim, mbajtësin e autorizimit individual që ka aplikuar, sipas pikës 9 të këtij neni, për vendimin e rivlerësimit të kufizimeve, në një afat të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se 60 ditë nga aplikimi. Mbajtësi i autorizimit individual ka të drejtë të tërhiqet, me shkrim, nga kërkesa për rishikimin e kufizimeve brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit të AKEP-it. Në rast se mbajtësi i autorizimit individual nuk tërhiqet, me shkrim, brenda 30 ditëve nga kërkesa për rishikimin e kufizimeve, atëherë vendimi i AKEP-it bëhet i detyrueshëm për mbajtësin e autorizimit individual.

11. Pas periudhës pesëvjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, AKEP-i merr masat për rivlerësimin e të gjitha autorizimeve të mbetura, në përputhje me kërkesat e pikës 5 të këtij neni.

12. Në zbatimin e kërkesave të këtij neni AKEP-i siguron konkurrencën e ndershme. Rivlerësimi i autorizimeve, sipas kërkesave të këtij neni, nuk do të thotë dhënie e një autorizimi të ri.”.

Neni 22

Neni 66 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 66

Dhënia në përdorim e frekuencave

Në përcaktimin e frekuencave që mund të përdoren, sipas autorizimit të përgjithshëm dhe në lëshimin e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave, AKEP-i mban parasysh që frekuencat janë një pasuri kombëtare me vlerë ekonomike dhe rëndësi sociale e kulturore. Dhënia në përdorim e frekuencave nga AKEP-i bëhet në bazë të parimit të objektivitetit, transparencës, proporcionalitetit e mosdiskriminimit, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, radiatorregulloret e ITU-së dhe në përputhje me objektivat rregullatorë të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji.”.

Neni 23

Në nenin 67, pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Kur përdorimi i radio frekuencave nuk është subjekt i autorizimit të përgjithshëm, sipas pikës 5 të nenit 65 të këtij ligji, apo subjekt i një konkurrimi publik, sipas neneve 68 e 69 të këtij ligji, AKEP-i lëshon autorizime individuale, sipas procedurave të përcaktuara në këtë nen. Nëse AKEP-i merr aplikime të ndryshme për autorizime individuale në të njëjtin brez frekuencash, i shqyrton ato sipas radhës së paraqitjes së tyre.”.

Neni 24

Neni 68 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 68

Marrja e mendimeve të palëve të interesuara

1. Nëse AKEP-i, në bazë të vlerësimit të tregut, konsideron se interesi për brezin e kërkuar të frekuencave mund të tejkalojë disponueshmërinë e frekuencave në këtë brez, si dhe për garantimin e një përdorimi efektiv të tyre, ai zhvillon një proces këshillimi publik me palët e interesuara, lidhur me kushtet e përdorimit të këtij brezi frekuencash dhe procedurën që mendohet të zbatohet për dhënien në përdorim të tyre.

2. AKEP-i është i detyruar të kryejë procesin e këshillimit publik me paraqitjen e një kërkesë, nga çdo palë e interesuar për frekuenca specifike, jo më vonë se 30 ditë pas paraqitjes së kërkesës. AKEP-i fillon procesin e këshillimit publik për frekuenca specifike, subjekt i mundshëm i të drejtave të kufizuara, edhe me kërkesë të ministrit.

3. Njoftimi për këshillim publik përmban të dhëna për frekuencat që do të caktohen, numrin e pritshëm të të drejtave të përdorimit që do të jepen, kushtet që mendohet të vendosen për këto të drejta përdorimi, kërkesën që palët e interesuara të shprehin mendimin e tyre për vlerën e tregut të frekuencave dhe të gjitha çështjet, për të cilat AKEP-i është i interesuar të marrë opinionin e palëve të interesuara. Afati i paraqitjes së mendimeve, në çdo rast, nuk do të jetë më pak se 30 ditë.

4. AKEP-i është i detyruar të respektojë konfidencialitetin e propozimeve të mundshme të bëra nga palët e interesuara për vlerën e tregut për këto frekuenca.

5. Brenda 30 ditëve pas afatit përfundimtar të paraqitjes së mendimeve të palëve të interesuara në procesin e këshillimit publik, AKEP-i publikon mendimet e tyre dhe qëndrimin e tij për çështjet e ngritura.

6. AKEP-i, mbështetur në përfundimet e tij, sipas pikës 5 të këtij neni, jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i këshillimit publik, i propozon ministrit kufizimin ose jo të të drejtave të përdorimit të frekuencave, procedurën e konkurrimit publik, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore për këtë qëllim, numrin e autorizimeve individuale, kriteret e vlerësimit dhe çmimin minimal për dhënien e tyre, duke konsideruar zhvillimin e konkurrencës, interesin publik dhe mbrojtjen e konsumatorit, rrethanat e tregut dhe përdorimin efektiv të frekuencave.

7. Ministri, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së propozimit të AKEP-it, sipas pikës 6 të këtij neni, miraton numrin e autorizimeve individuale, vlerën minimale për dhënien e tyre dhe nxjerr urdhër për fillimin e konkurrimit publik, sipas nenit 69 të këtij ligji. Në çdo rast, vendimi për kufizimin e të drejtave të përdorimit duhet të jetë i arsyetuar.

8. Kur në përfundim të procesit të këshillimit të kryer, sipas këtij neni, kufizimi i numrit të autorizimeve individuale nuk është i nevojshëm dhe nëse kjo nuk është në kundërshtim me interesin e përdoruesve ose me interesin e zhvillimit të konkurrencës ekonomike, AKEP-i vijon procesin me dhënien e autorizimit individual, sipas nenit 67 të këtij ligji, pasi të marrë miratimin e ministrit për vijimin e procedurës dhe vlerën minimale të dhënies në përdorim të frekuencave.

9. Fituesi i së drejtës për përdorimin e frekuencave, që jepen me procedurën e konkurrimit publik, sipas nenit 69 të këtij ligji, kryen një pagesë për frekuencat në vlerën e arritur në procesin e konkurrimit, e cila derdhet në Buxhetin e Shtetit.”.

Neni 25

Në nenin 69 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit bëhet “Procedura e konkurrimit publik”.

2. Në pikën 1 fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“1. Jo më vonë se 15 ditë pas miratimit të ministrit, sipas pikës 7 të nenit 68 të këtij ligji, AKEP-i zhvillon procedurën e konkurrimit publik për të dhënë autorizime individuale për një numër të kufizuar të drejtash për përdorimin e frekuencave, sipas rregullave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit, për procedurën përkatëse.”.

Neni 26

Në nenin 72, në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Kohëzgjatja do të jetë e përshtatshme për shërbimin e ofruar në këndvështrim të objektivit të caktuar, duke marrë parasysh nevojën për të lejuar një periudhë të përshtatshme për kthimin e investimit.”.



Neni 27

Në nenin 73, në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rastin e autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim, rregullat dhe procedurat e rinovimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.”.

Neni 28

Në nenin 75, pika 3 shfuqizohet.

Neni 29

Në nenin 77, në fillim të pikës 2 shtohen fjalët “Në rastet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni.”.

Neni 30

Në nenin 79, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Rregullat teknike për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.”.

Neni 31

Në nenin 82, në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“AKEP-i vendos për këto aplikime brenda jo më shumë se tri javëve.”.

Neni 32

Në nenin 87 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Parashikimi i pikës 1 të këtij neni zbatohet për të gjithë numrat e Planit të Numeracionit. AKEP-i mund të përcaktojë seri numrash, të cilat nuk janë subjekt i mbartjes së numrit.”.

2. Në pikën 5, fjala “gjeografik” zëvendësohet me fjalën “jogjeografik”.

3. Në pikën 6 hiqen fjalët “pajtimtarët e tyre ose”.

4. Pas pikës 7 shtohen pikat 8, 9 e 10 me këtë përmbajtje:

“8. Në rastet e parashikuara në pikën 4 të nenit 56 të këtij ligji, AKEP-i nuk imponon tarifa të pakicës për mbartjen e numrave, përmes caktimit të një tarife të përbashkët ose specifike për përdoruesit fundorë që mund të deformojnë konkurrencën.

9. Mbartja e numrave dhe aktivizimi i tyre bëhen brenda një afati sa më të shkurtër kohor. Në rastet kur pajtimtari ka lidhur kontratë për mbartjen e numrit të një sipërmarrës i ri, aktivizimi i numrit bëhet brenda një dite pune. Në çdo rast ndërprerja e shërbimit gjatë procesit të mbartjes nuk do të jetë më e gjatë se një ditë.

10. AKEP-i mund të parashikojë, në rregullore, përjashtime nga parimi i përcaktuar në pikën 9 të këtij neni, në raste të justifikuara dhe kur është e nevojshme, në lidhje me procese të veçanta për mbartjen e shumë numrave në të njëjtën kohë.”.

Neni 33

Në nenin 96, fjalët “rrjetin e brendshëm telefonik” zëvendësohen me fjalët “infrastrukturën për rrjetin e brendshëm të komunikimeve elektronike”.

Neni 34

Neni 98 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 98

Transparenca dhe publikimi i informacionit

1. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun publikojnë informacion transparent, të krahasueshëm, të përshtatshëm dhe të përditësuar për tarifat dhe çmimet e aplikuara, çdo detyrim në përfundimin e kontratës, si dhe kushtet e përgjithshme për aksesin e përdorimin e shërbimeve të ofruara nga ata për përdoruesit fundorë, në përputhje me pikën 2 të këtij neni. Ky informacion publikohet në mënyrë të qartë, gjithëpërfshirëse dhe lehtësisht të aksesueshme. AKEP-i mund të përcaktojë, me rregullore, kërkesat shtesë lidhur me formën në të cilën këto informacione do të publikohen.

2. AKEP-i mund të vendosë, nëpërmjet një rregulloreje, se çfarë informacioni publikohet nga sipërmarrësi, i cili ofron rrjete të komunikimit publik dhe/ose shërbime telefonike të disponueshme për publikun dhe çfarë informacioni publikohet nga vetë AKEP-i për të garantuar që konsumatorët mund të marrin vendime të mirinformuar.

AKEP-i garanton që publikohet informacioni i mëposhtëm:

a) emrat dhe adresat e sipërmarrësve, të cilët ofrojnë rrjete të komunikimeve publike dhe/ose shërbime telefonike të disponueshme për publikun;

b) fushëveprimi i shërbimit të ofruar dhe gatishmëria gjeografike e shërbimeve;

c) tarifat standarde, të cilat tregojnë shërbimet e ofruara dhe përmbajtjen e secilit element të tarifave (p.sh. detyrimet për akses, të gjitha llojet e detyrimeve për përdorimin, detyrimet për mirëmbajtje), duke përfshirë detajet e zbritjeve standarde të aplikuara, planet tarifore speciale e të orientuara, çdo detyrim shtesë, si dhe kostot lidhur me pajisjet fundore;

ç) politika e kompensimit/rimbursimit, përfshirë hollësitë specifike të çdo plani të ofruar për kompensim/rimbursim;

d) llojet e ofruara të shërbimit të mirëmbajtjes;

dh) kushtet e përgjithshme, duke përfshirë periudhën minimale kontraktuale, përfundimin e kontratës, procedurat dhe detyrimet e drejtpërdrejta të lidhura me portabilitetin e numrit dhe tregues të tjerë, nëse janë me rëndësi;

e) mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, përfshirë ato të zhvilluara nga sipërmarrësit;

ë) informacion për të drejtat lidhur me shërbimin universal, duke përfshirë, nëse është e përshtatshme, facilitetet dhe shërbimet e përmendura pikën 6 të nenit 27 të këtij ligji.

3. AKEP-i inkurajon ofrimin e informacioneve krahasuese për t'u mundësuar përdoruesve fundorë dhe konsumatorëve të bëjnë një vlerësim të pavarur të kostos së përdorimit të modeleve alternative, për shembull, duke përdorur një guidë interaktive ose teknika të ngjashme. Kur këto facilitete nuk janë të disponueshme pa pagesë ose me çmim të arsyeshëm në treg, AKEP-i do t'i vërë vetë në dispozicion këto guida ose teknika. Palët e treta mund të përdorin, pa pagesë, informacionin e publikuar nga sipërmarrësit që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun, me qëllim të shitjes ose vënies në dispozicion të këtyre guidave ose teknikave të ngjashme.

4. AKEP-i mund të detyrojë sipërmarrësit, të cilët ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, ndërmjet të tjerash:

a) t'u ofrojnë pajtimtarëve informacion për tarifat e aplikueshme për çdo numër ose shërbim, subjekt i kushteve të veçanta të tarifimit. Lidhur me kategoritë individuale të shërbimeve, AKEP-i mund të kërkojë që ky informacion të ofrohet menjëherë para lidhjes së thirrjes;

b) të informojnë pajtimtarët për çdo ndryshim të aksesit në shërbime të emergjencës ose të informacionit për vendndodhjen e numrit thirrës në shërbimin ku janë pajtuar;



c) të informojnë pajtimtarët për çdo ndryshim të kushteve që kufizojnë aksesin në, dhe/ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikimeve dhe ku këto shërbime janë të lejueshme sipas ligjeve në fuqi;

ç) të ofrojnë informacion për çdo procedurë të vendosur nga ofruesi, në mënyrë që të masë dhe drejtojë trafikun, për të evituar ngarkesën ose mbingarkesën e lidhjeve të rrjetit dhe si këto procedura mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit;

d) të informojnë pajtimtarët për të drejtën e tyre për të vendosur për të përfshirë ose jo të dhënat e tyre personale në numëror, si dhe për llojin e të dhënave, në përputhje me nenin 104 të këtij ligji;

dh) të informojnë rregullisht pajtimtarët me aftësi të kufizuara për detajet e produkteve dhe shërbimeve të projektuara për ata.

5. Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit kushtet e përgjithshme të kontratave tip dhe t'ia paraqesin ato AKEP-it për vlerësim, të paktën, 15 ditë para publikimit.”.

Neni 35

Në nenin 99 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) shërbimet e ofruara, cilësinë e shërbimit të ofruar, si dhe kohën për lidhjen fillestare, duke përfshirë:

i) nëse ofrohet aksesin në shërbimet e emergjencës dhe informacioni për vendndodhjen e numrit thirrës dhe çdo kufizim në ofrimin e shërbimeve të emergjencës;

ii) informacion për çdo kusht tjetër që kufizon aksesin në, dhe/ose përdorimin e shërbimeve dhe aplikimeve, ku këto kushte lejohen, sipas këtij ligji;

iii) informacion për çdo procedurë të vendosur nga sipërmarrësi për të matur dhe drejtuar trafikun, në mënyrë që të evitohet ngarkesa ose mbingarkesa e lidhjeve të rrjetit dhe si këto procedura mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit;

iv) çdo kufizim të vendosur nga ofruesi për përdorimin e pajisjeve fundore të ofruara;

v) nivelet minimale të cilësisë së shërbimit të ofruar si koha për lidhje fillestare dhe, kur është e përshtatshme, dhe cilësia e parametra të tjerë, siç përcaktohen nga AKEP-i;”.

b) Shkronja “dh” riformulohet si më poshtë:

“dh) një informacion për hyrjen në fuqi, kohëzgjatjen e kontratës së pajtimtarit, kushtet për shtyrjen dhe përfundimin e kontratës dhe të ofrimit të shërbimeve, duke përfshirë:

i) çdo minimum të përdorimit ose kohëzgjatjes së nevojshme për të përfituar nga kushtet e ofruara promionale;

ii) çdo detyrim lidhur me mbartjen e numrit dhe tregues të tjerë;

iii) çdo detyrim të papaguar me përfundimin e kontratës, duke përfshirë çdo rimbursim të koston në lidhje me pajisjet fundore;”.

c) Pas shkronjës “gj” shtohet shkronja “h” me këtë përmbajtje:

“h) llojin e veprimit që mund të ndërmerret nga sipërmarrësi si kundërveprim ndaj incidenteve të sigurisë ose integritetit apo për shkak të kërcënimeve dhe cenimeve.”.

2. Pikat 3, 4 e 5 ndryshohen si më poshtë:

“3. Pajtimtarët kanë të drejtë të tërhiqen nga kontrata pa penalitet përkundërt njoftimit të modifikimit të kushteve kontraktore të propozuara nga sipërmarrësi që ofron rrjete të komunikimit elektronik dhe/ose shërbime. Pajtimtarëve u jepet njoftimi i përshtatshëm, jo më pak se 30 ditë përpara për çdo modifikim dhe informohen në të njëjtën kohë për të drejtën e tyre për t'u tërhequr pa penalitet nga kontrata, nëse ata nuk i pranojnë kushtet e reja. AKEP-i mund të përcaktojë, nëpërmjet një rregulloreje, formatin e këtyre njoftimeve.

Përfundimi i kontratës, për shkak të mospranimit të ndryshimeve, nuk e shmang pajtimtarin nga përmbushja e detyrimeve bazë të kontratës së mëparshme.

4. Kontratat e lidhura ndërmjet konsumatorëve dhe sipërmarrësve të shërbimeve të komunikimeve elektronike nuk duhet të detyrojnë lidhjen e kontratës me një afat fillestar prej më shumë se 24 muaj. Sipërmarrësit kanë detyrimin t'u ofrojnë përdoruesve mundësinë e lidhjes së kontratës me afat maksimal 12 muaj. Pavarësisht nga kohëzgjatja minimale e kontratës, kushtet dhe procedurat për përfundimin e kontratës nuk duhet të pengojnë/dekurajojnë pajtimtarin për ndryshimin e ofruesit të shërbimit.

5. Kontrata e pajtimit, që lidhet ndërmjet sipërmarrësit dhe pajtimtarit, bazohet në parimin e barazisë mes palëve. Ajo hartohet nga sipërmarrësit mbi bazën e legjislacionit në fuqi dhe rregullave të nxjerra nga AKEP-i në zbatim të këtij ligji. Një kopje tip e saj, si dhe çdo ndryshim i mëvonshëm që mund të pësojë, i dërgohet AKEP-it 15 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre. AKEP-i ka të drejtë të përcaktojë rregulla shtesë, si dhe të imponojë ndryshime, kur kontratat e pajtimit nuk janë në përputhje me ligjin dhe aktet normative të nxjerra për këtë qëllim, pas kryerjes së një procesi konsultimi, sipas nenit 110 të këtij ligji.”.

Neni 36

Neni 101 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 101

Ruajtja dhe administrimi i të dhënave për qëllime të ndjekjes penale

1. Pavarësisht përcaktimeve të tjera në këtë ligj, sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike detyrohen të ruajnë dhe të administrojnë, për një afat 2-vjeçar, skedarët e të dhënave për pajtimtarët e tyre.

2. Skedarët duhet të përmbajnë të dhëna në lidhje me komunikimin zanor dhe me SMS/MMS, që mundësojnë:

a) identifikimin e pajtimtarëve, duke siguruar marrjen dhe regjistrimin e identitetit të plotë të tyre;

b) identifikimin e pajisjes fundore, të përdorur gjatë komunikimeve;

c) përcaktimin e vendndodhjes, datës, kohës, kohëzgjatjes së komunikimit dhe numrit të thirrur dhe thirrës, përfshirë të dhënat për thirrjet pa përgjigje.

3. Në rastin e komunikimeve në internet, skedari duhet të përmbajë:

a) të dhëna të nevojshme për ndjekjen dhe identifikimin e burimit/origjinimit të komunikimit:

i) identitetin e pajtimtarit (*user ID*) të caktuar;

ii) identitetin e pajtimtarit (*user ID*) dhe numrin e telefonit të caktuar për komunikimet që hyjnë në rrjetin publik telefonik;

iii) emrin dhe adresën e pajtimtarit ose përdoruesit të regjistruar, të cilit i është caktuar një adresë IP, identitetin e përdoruesit (*user ID*), ose numër telefoni i caktuar gjatë kohës së komunikimit;

b) të dhëna të nevojshme për identifikimin e destinacionit të komunikimit:

i) në rastin e telefonisë në internet, identitetin e përdoruesit (*user ID*) ose numrin e telefonit të numrit të thirrur;

ii) në rastin e postës elektronike ose telefonisë në internet, emrin dhe adresën e pajtimtarit ose përdoruesit të regjistruar dhe identitetin e përdoruesit (*user ID*) të marrësit të synuar të komunikimit;

c) të dhëna të nevojshme për identifikimin e datës, kohës dhe kohëzgjatjes së komunikimit:

i) datën dhe orën e lidhjes (*log in*) dhe shkëputjes (*log off*) të shërbimit të aksesit në internet, sipas orës lokale;

ii) adresën IP, duke përcaktuar nëse është dinamike apo statike, të caktuar nga ofruesi i shërbimit internet;

iii) identitetin e pajtimtarit ose përdoruesit të regjistruar të shërbimit të aksesit internet.

4. Detyrimi për ruajtjen e të dhënave për thirrjet pa përgjigje, sipas shkronjës “c” të pikës 2, për komunikimet zanore, si dhe detyrimi për të dhënat, sipas nënshkronjës “i” të shkronjës “c” të pikës 3 të



këtij neni, për komunikimet në internet, zbatohet për aq sa këto të dhëna krijohen ose përpunohen dhe ruhen nga ofruesi i shërbimeve dhe/ose rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, brenda juridiksionit të tyre gjatë ofrimit të shërbimeve të komunikimeve prej tyre.

5. Të dhënat në këta skedarë ruhen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Këta skedarë duhet t'u vihen në dispozicion pa vonesë, edhe në formë elektronike, autoriteteve që përcakton Kodi i Procedurës Penale, në bazë të kërkesës së tyre.”.

Neni 37

Pas nenit 101 shtohet neni 101/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 101/1 **Shkatërrimi i të dhënave të ruajtura**

Operatorët e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike janë të detyruar të shkatërrojnë të dhënat e ruajtura, në përfundim të afatit të ruajtjes, kur nuk është parashikuar ndryshe në legjislacionin në fuqi.”.

Neni 38

Në nenin 102, në fund të pikës 1 shtohen fjalët “dhe për masat e marra për të garantuar akses të barabartë për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara.”.

Neni 39

Pas nenit 102 shtohet neni 102/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 102/1 **Garantimi i aksesit të barabartë dhe mundësisë së zgjedhjes për përdoruesit me aftësi të kufizuara**

1. AKEP-i, kur është e përshtatshme, përcakton nëpërmjet një rregulloreje kërkesat që duhet të plotësohen nga sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, për të garantuar që përdoruesit me aftësi të kufizuara:

a) kanë akses në shërbime të komunikimeve elektronike të barabartë me atë të përdorur nga shumica e përdoruesve fundorë;

b) përfitojnë nga zgjedhja e sipërmarrësve dhe shërbimeve në dispozicion të shumicës së përdoruesve fundorë.

2. Në mënyrë që të miratojë dhe implementojë masat e veçanta për përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara, AKEP-i inkurajon disponueshmërinë e pajisjeve fundore, të cilat ofrojnë shërbimet dhe funksionet e nevojshme për këta përdorues.”.

Neni 40

Neni 103 shfuqizohet.

Neni 41

Në nenin 104 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Sipërmarrësit që ofrojnë shërbime telefonike të disponueshme për publikun janë të detyruar:

a) të informojnë, pa pagesë, të gjithë pajtimtarët para se ata të përfshihen në një numërorat telefonik publik, për qëllimin e numërorit dhe funksionet e disponueshme të kërimit të informacionit;

b) t'u ofrojnë të gjithë pajtimtarëve, pa pagesë, mundësinë për të vendosur nëse të dhënat e tyre personale mund të përfshihen në një numërorat publik, për të përzgjedhur të dhënat që nuk dëshirojnë të përfshihen dhe mundësinë për të verifikuar dhe korrigjuar këto të dhëna;

c) t'u ofrojnë të gjithë pajtimtarëve, pa pagesë, mundësinë e mospërfshirjes së të dhënave të tyre personale ose heqjes së të dhënave nga një numërorat telefonik.

3. Sipërmarrësit janë të detyruar të marrin pëlqimin paraprak të pajtimtarit në rastin e përfshirjes së tyre në numërorin publik. Të gjithë përdoruesit fundorë të shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun duhet të kenë akses në cilëndo rubrikë të shërbimeve të informacionit për numërorin telefonik.”.

2. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 42

Në nenin 106 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pas fjalëve “janë të detyruar t'u ofrojnë” shtohen fjalët “pa pagesë”.

b) Në fund të kësaj pike shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Pajtimtarët, gjithashtu, kanë të drejtë të marrin faturë jo të detajuar pa pagesë. Në të dyja rastet, sipërmarrësi duhet të sigurojë dërgimin, pa pagesë, të faturës së detajuar ose jo të detajuar, në adresën e pajtimtarit, sipas opsionit të zgjedhur nga pajtimtari.”.

2. Në pikën 3 shkronja “ç”, fjala “orën” zëvendësohet me fjalën “kohën”.

Neni 43

Neni 107 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 107

E drejta e ankimit

1. Mënyra dhe procedura për ankesat e pajtimtarëve përcaktohen në kushtet e kontratës të pajtimtarit.

2. Pajtimtarët kanë të drejtë të ankohen apo të kërkojnë sqarime tek operatori që ofron shërbime të komunikimeve elektronike për kushtet kontraktore dhe/ose përmbushjen e këtyre kushteve nga operatori, përfshirë faturën dhe cilësinë e shërbimit të ofruar.

3. Në rast se pajtimtari nuk është i kënaqur me sqarimet e dhëna nga operatori nëpërmjet telefonit apo njoftimeve të tjera me mjetet elektronike, ai mund të ankohet me shkrim. Ankesa duhet të paraqitet:

a) brenda 15 ditëve nga marrja e faturës për shërbimin e ofruar, nëse ankesa i referohet shumës së faturuar për shërbimin e ofruar; ose

b) brenda 15 ditëve nga ofrimi i shërbimit, nëse ankesa i referohet cilësisë së shërbimit të ofruar.

4. Pas marrjes së ankesës së referuar në pikën 2 të këtij neni, sipërmarrësi duhet të verifikojë shumën e faturuar për shërbimet e ofruara ose për cilësinë e shërbimeve të ofruara dhe, pas verifikimit, të konfirmojë shumën e faturuar ose ta korrigjojë atë. Sipërmarrësi i dorëzon pajtimtarit përgjigjen, me shkrim, jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së ankesës nga pajtimtari.

5. Nëse pajtimtari, nuk është dakord me përgjigjen me shkrim të sipërmarrësit, pajtimtari mund të fillojë një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, sipas nenit 120/1 të këtij ligji, ose mund ta paraqesë rastin para gjykatës, sipas Kodit të Procedurës Civile.”.



Neni 44

Në nenin 109, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Sipërmarrësi është i detyruar t'i dërgojë faturën pajtimtarit me paspagim. Nëse pajtimtari nuk përmbush detyrimet kontraktore brenda afatit kohor të përcaktuar në faturë, sipërmarrësi është i detyruar t'i dërgojë pajtimtarit një njoftim me shkrim ose në një formë tjetër që është parashikuar dhe pranuar në kontratë nga pajtimtari, duke vendosur afatin kohor prej jo më pak se 15 ditëve për të përmbushur detyrimet kontraktore. Ky njoftim me shkrim duhet të informojë pajtimtarin për kushtet përkatëse kontraktore, në veçanti për kufizimin, ndërprerjen e shërbimit apo ndërprerjen e kontratës dhe procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Sipërmarrësit nuk duhet të veprojnë në përputhje me pikën 1 të këtij neni para afatit kohor të përcaktuar në njoftimin me shkrim.”.

Neni 45

Në nenin 110 pika 1, pas fjalëve “të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike” shtohen fjalët “ose që kanë lidhje me të drejtat e përdoruesve fundorë, në veçanti përdoruesit me aftësi të kufizuara”.

Neni 46

Në nenin 114 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 4, fjalët “7 vjet” zëvendësohen me fjalët “10 vjet”.
2. Në pikën 5 bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a) Fjalët “nga çdo post ose funksion zyrtar” zëvendësohen me fjalët “nga çdo post ose funksion zyrtar e partiak”.
 - b) Në fund të kësaj pike shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Për këto veprime, anëtari informon me shkrim Kuvendin.”.

Neni 47

Në nenin 115 pika 1, fjala “bosh” zëvendësohet me fjalët “mungesë ose vend vakant”.

Neni 48

Në nenin 116 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “nga organi që e ka zgjedhur” shtohen fjalët “me propozim të Këshillit të Ministrave, kur:”.
2. Në pikën 3 hiqen fjalët “i liruar ose”.
3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:
“4. Para se të lirohet ose shkarkohet një anëtar i Këshillit Drejtues, atij i jepet mundësia për të parashtruar pretendimet e tij para komisioneve të Kuvendit. Vendimi për të liruar dhe shkarkuar kryetarin, një anëtar ose më shumë se një anëtar duhet të jetë i bazuar në ligj dhe të jetë i arsyetuar për shkaqet që çojnë në lirim ose shkarkimin e tyre. Vendimi i Kuvendit publikohet.”.

Neni 49

Në nenin 117 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “nenet 24 dhe 119 të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “nenet 24, 78 dhe 86 të këtij ligji”.
2. Në fund të pikës 2 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
“Jo më vonë se tre muaj nga përfundimi i vitit financiar, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare përgatit projektbuxhetin, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Projektbuxheti i AKEP-it

propozohet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Ministrave si bashkëpropozim i ministrit me Ministrin e Financave.”.

3. Në fund të pikës 3 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“AKEP-i zbaton rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe aktet e tjera nënligjore që rregullojnë e përcaktojnë kufijtë e përdorimit të nivelit të shpenzimeve.”.

Neni 50

Në nenin 118, pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Dokumentacioni i arkivuar në AKEP për veprimtarinë e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike është i hapur për publikun, në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit publik dhe legjislacionin përkatës për sekretin tregtar të biznesit.”.

Neni 51

Në nenin 119, pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:

“3. Përcaktimi i pagesave për caktimin dhe përdorimin e frekuencave e të numrave bëhet në bazë të parimit të proporcionalitetit, transparencës dhe objektivitetit, duke minimizuar shpenzimet administrative shtesë dhe taksat shtesë. Në veçanti:

a) të ardhurat totale vjetore nga pagesat e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni duhet të përputhen me koston administrative vjetore të AKEP-it për administrimin e radiofrekuencave dhe numrave;

b) ndryshimi i pagesave për breza të ndryshëm të frekuencave ose për kategoritë e ndryshme të numrave duhet të përputhet me ndryshimin në koston administrative për administrimin e këtyre brezave dhe kategoritë e ndryshme të numrave.

4. AKEP-i, në zbatim të parimit të transparencës, çdo vit publikon, në faqen e tij zyrtare, një përmbledhje të situatës financiare, duke dhënë kostot administrative/shpenzimet dhe të ardhurat totale të krijuara respektivisht nga pagesat për mbikëqyrjen e tregut, pagesat për numeracionin dhe ato për frekuencat. AKEP-i, gjithashtu, publikon bilancin financiar vjetor që depoziton në organet tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim.”.

Neni 52

Titulli i nenit 120 bëhet “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet sipërmarrësve”.

Neni 53

Pas nenit 120 shtohet neni 120/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 120/1

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve

1. Nëse një mosmarrëveshje mes një pajtimtari dhe një sipërmarrësi që ofron shërbime të komunikimit publik nuk mund të zgjidhet nëpërmjet procedurave për trajtimin e ankesave, sipas nenit 107 të këtij ligji, pajtimtari mund të kërkojë nga AKEP-i të zgjidhë mosmarrëveshjen.

2. Kërkesa e pajtimtarit, referuar në pikën 1 të këtij neni, paraqitet me shkrim dhe duhet të përmbajë fakte dhe prova, në të cilat është bazuar. Kërkesa duhet të paraqitet brenda 15 ditëve pasi pajtimtari të ketë marrë nga sipërmarrësi përgjigjen me shkrim, të referuar në nenin 107 pika 4 të këtij ligji.



3. AKEP-i zgjidh mosmarrëveshjet në mënyrë transparente, të shpejtë, objektive dhe jodiskriminuese brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës.

4. Sipërmarrësit që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike duhet të marrin pjesë në procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve e të bashkëpunojnë me AKEP-in, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes, dhe t'i paraqesin këtij të fundit të gjitha të dhënat e nevojshme.

5. Kur AKEP-i të ketë shqyrtuar të gjitha provat në dispozicion, i paraqet pajtimtarit dhe sipërmarrësit një rekomandim, me shkrim, si duhet zgjidhur mosmarrëveshja. Nëse të dyja palët, pajtimtari dhe sipërmarrësi, pranojnë, me shkrim, rekomandimin brenda 15 ditëve, ai bëhet i detyrueshëm. Në rast të kundërt, secila palë mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.

6. AKEP-i përcakton procedurat dhe strukturën përkatëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me anë të një rregulloreje. Procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjes pranë AKEP-it është pa pagesë.

7. Kur AKEP-i konstaton se një çështje e caktuar është subjekt i shumë kërkesave për zgjidhje të mosmarrëveshjeve me një sipërmarrës të caktuar, ekzaminon nëse procedura për trajtimin e ankesave, sipas nenit 107 të këtij ligji, zbatohet në mënyrë të duhur nga sipërmarrësi. Nëse është e nevojshme, AKEP-i detyron sipërmarrësin të përmirësojë procedurat për trajtimin e ankesave.”.

Neni 54

Në nenin 122 bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në mënyrë të veçantë duhet të merren masa për të parandaluar dhe minimizuar ndikimin e aksidenteve të sigurisë mbi përdoruesit e rrjeteve të ndërlidhura.”.

2. Në fund të pikës 2 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Masat duhet që, të paktën:

a) të sigurojnë që të dhënat personale të jenë të aksesueshme vetëm nga personeli i autorizuar për qëllime ligjore të autorizuar;

b) të mbrojnë të dhënat personale të ruajtura ose të transmetuara nga aksidentet apo nga shkatërrimi i kundërligjshëm, humbja ose ndryshimi aksidental dhe ruajtja, përpunimi, aksesimi apo zbulimi i paautorizuar ose i jashtëligjshëm;

c) të sigurojnë implementimin e politikave të sigurisë, lidhur me përpunimin e të dhënave personale.”.

3. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 deri në 13 me këtë përmbajtje:

“4. Në rast të cenimit të të dhënave personale, sipërmarrësi që ofron shërbime të komunikimeve elektronike të vlefshme për publikun njofton pa vonesë AKEP-in për këtë shkelje.

5. Kur një shkelje e të dhënave personale mund të ndikojë për keq në të dhënat personale dhe privatësinë e pajtimtarit ose individit, sipërmarrësi, gjithashtu, njofton pa vonesë pajtimtarin ose individin për shkeljen.

6. Nëse sipërmarrësi i ka vërtetuar AKEP-it që i ka zbatuar masat e nevojshme mbrojtëse teknologjike dhe këto masa janë aplikuar për të dhënat përkatëse, atëherë nuk kërkohet nga sipërmarrësi të njoftojë pajtimtarin ose individin për shkeljen e të dhënave personale. Këto masa mbrojtëse teknologjike i bëjnë këto të dhëna të palexueshme për çdo person që nuk ka akses të autorizuar në këto të dhëna.

7. Pa paragjykim ndaj detyrimit të sipërmarrësit për të njoftuar pajtimtarët dhe individët në fjalë, nëse sipërmarrësi nuk e ka njoftuar pajtimtarin ose individin për shkelje të të dhënave personale, AKEP-i, pasi të ketë marrë parasysh ndikimin për keq të shkeljes, mund të kërkojë që sipërmarrësi të njoftojë pajtimtarin.

8. Njoftimi i pajtimtarit ose individit përshkruan, të paktën, natyrën e shkeljes së të dhënave personale dhe personin e kontaktit ku mund të merret informacion më i detajuar, si dhe rekomandon masa për të minimizuar efektet e mundshme të këqija të shkeljes së të dhënave personale. Njoftimi për AKEP-in, përveç kësaj, përshkruan pasojat dhe masat e propozuara ose të ndërmarra nga ofruesi për 8080

shkeljen e të dhënave personale.

9. Sipërmarrësit mbajnë një inventar të shkeljeve të të dhënave personale, që përmban fakte lidhur me këto shkelje, ndikimin e tyre dhe masat e ndërmarra rregullatore, të mjaftueshme për t'u mundësuar autoriteteve kompetente kombëtare verifikimin e përputhjes me përcaktimet e pikës 3. Ky inventar përfshin vetëm informacion të nevojshëm për këtë qëllim.

10. AKEP-i mund të përcaktojë me hollësi detyrimet e pikave 1 deri në 9 të këtij neni me anë të një rregulloreje. Në veçanti AKEP-i mund të kërkojë që sipërmarrësit:

a) të ofrojnë informacion të nevojshëm për të vlerësuar sigurinë dhe/ose integritetin e shërbimeve dhe rrjeteve, duke përfshirë politika të dokumentuara të sigurisë;

b) t'i paraqesin auditit të sigurisë, të kryer nga një organ i certifikuar dhe i pavarur ose nga një autoritet kompetent, rezultatet dhe në këtë mënyrë t'i vënë ato në dispozicion të AKEP-it. Kostoja e auditit do të paguhet nga sipërmarrësi.

11. Në rast të shkeljes së sigurisë ose kur auditit i sigurisë zbulon masa jo të mjaftueshme të sigurisë, AKEP-i me një vendim i detyron sipërmarrësit të zbatojnë masat e nevojshme të sigurisë. AKEP-i mund të përcaktojë kërkesat minimale për masat që duhet të merren dhe afatet kohore për zbatimin e tyre.

12. AKEP-i mund të informojë vetë publikun ose të kërkojë nga sipërmarrësi që ta njoftojë atë, nëse vlerëson që bërja publike e kësaj shkeljeje është në interes të publikut.

13. AKEP-i mund të shkëmbejë informacion për shkeljet e sigurisë me Komisionin Europian dhe Agjencinë Europiane për Sigurinë e Rrjeteve dhe të Informacionit (ENISA), si dhe me autoritetet kompetente në vendet e tjera, në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave për transferimin ndërkombëtar.”.

Neni 55

Në nenin 123, pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Përdorimi i rrjeteve të komunikimit elektronik për ruajtjen e të dhënave apo për marrjen e aksesit në të dhënat e ruajtura në pajisjet fundore të pajtimtarit ose të përdoruesit për përpunim të mëtejshëm lejohet vetëm në rastet kur pajtimtari ose përdoruesi në fjalë ka dhënë pëlqimin, duke i ofruar informacion të qartë dhe të kuptueshëm për qëllimin e përpunimit, sipas kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo nuk parandalon çdo ruajtje teknike ose aksesin vetëm për qëllim të transmetimit të një komunikimi nëpërmjet një rrjeti të komunikimeve elektronike, ose kur kjo është e domosdoshme që një ofruer i shërbimit të shoqërisë së informacionit të ofrojë shërbimin e kërkuar në mënyrë të qartë nga pajtimtari.”.

Neni 56

Në nenin 128 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “vetëm pas miratimit paraprak të pajtimtarëve” shtohen fjalët “i cili mund të revokohet në çdo kohë”.

2. Në pikën 2, fjalët “Ndalohet dërgimi i një mesazhi nëpërmjet postës elektronike” zëvendësohen me fjalët “Ndalohet dërgimi i një mesazhi me SMS ose nëpërmjet postës elektronike”.

Neni 57

Neni 130 shfuqizohet.

Neni 58

Në nenin 135 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si më poshtë:



“1. Kur inspektorët e AKEP-it vërtetojnë se një sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo person tjetër fizik a juridik, që ushtron veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike, ka shkelur këtë ligj dhe rregulloret e miratuara:

a) i propozojnë Këshillit Drejtues të AKEP-it masën e gjobës, sipas nenit 137 pika 1 të këtij ligji, për shkeljet e parashikuara në paragrafët I deri në IV të tij, dhe masat për ndreqjen e shkeljes së konstatuar;

b) vendosin gjobë, sipas nenit 137 pika 1 të këtij ligji, për shkeljet e parashikuara në paragrafët V deri në VIII të tij dhe kërkojnë marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes, duke vendosur një afat për realizimin e saj.”.

2. Në pikën 3, fjalët “shkronjat “a” e “b” të pikës 2” zëvendësohen me fjalët “shkronjën “a” të pikës 1 dhe shkronjat “a” e “b” të pikës 2”.

Neni 59

Në nenin 136 pika 1, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“1. Kundër gjobës së vendosur, sipas këtij ligji, bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP-it brenda 10 ditëve nga data e dhënies së saj.”.

Neni 60

Në nenin 137 bëhen këto ndryshime:

1. Në paragrafin I bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjalja e parë ndryshohet si më poshtë:

“I. Me gjobë në vlerën nga 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) deri në 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, për shkeljet e mëposhtme të kryera nga personi juridik:”.

b) Në pikën 9, fjala “urdhër” zëvendësohet me fjalën “vendim”.

c) Pas pikës 19 shtohet pika 20 me këtë përmbajtje:

“20. Nuk përmbush detyrimet për ruajtjen e të dhënave, sipas neneve 101 dhe 101/1 të këtij ligji.”.

2. Paragrafi II ndryshohet si më poshtë:

“II. Me gjobë në vlerën nga 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për shkeljet e cilësuar në paragrafin I të këtij neni, të kryera nga personi fizik.”.

3. Në paragrafin III bëhen këto ndryshime:

a) Fjalja e parë ndryshohet si më poshtë:

“III. Me gjobë në vlerën nga 10 000 000 (dhjetë milionë) deri në 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, për shkeljet e mëposhtme të kryera nga personi juridik:”.

b) Pika 30 ndryshohet si më poshtë:

“30. Nuk vepron në përputhje me kërkesat e nenit 128 të këtij ligji për komunikimet pa kërkesë.”.

c) Pika 31 shfuqizohet.

4. Paragrafi IV ndryshohet si më poshtë:

“IV. Me gjobë në vlerën nga 1 000 000 (një milion) deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë për shkeljet e cilësuar në paragrafin III të këtij neni, të kryera nga personi fizik.”.

5. Në paragrafin V fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“V. Me gjobë në vlerën deri në 1 000 000 (një milion) lekë, për shkeljet e mëposhtme të kryera nga personi juridik:”.

6. Paragrafët VI, VII e VIII ndryshohen si më poshtë:

“VI. Me gjobë në vlerën deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për shkeljet e cilësuar në paragrafin V të këtij neni, të kryera nga personi fizik.

VII. Me gjobë në vlerën deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë, për çdo shkelje tjetër të kryer nga personi juridik, të pacilësuar në pikat e mësipërme.

VIII. Me gjobë në vlerën deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë ndaj personit fizik, për shkeljet e cilësuar në paragrafin VII të këtij neni.”.

7. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Në vendosjen e gjobave, sipas këtij neni, do të merret parasysh:

- a) rëndësia dhe kohëzgjatja e kundërvajtjes;
- b) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;
- c) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;
- ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.”.

Neni 61

Dispozita të veçanta dhe kalimtare

1. AKEP-i imponon detyrime rregullatore, sipas neneve 43 e 44 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, për aq sa është e nevojshme për të rregulluar dështimet e tregut dhe nëse detyrimet e imponuara rregullatore për tregjet me shumicë nuk janë të mjaftueshme.

2. Procedura e konkurrimit publik, sipas nenit 69 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, mund të mbështetet në një këshillim publik të kryer para se amendimet e neneve 68 dhe 69 të këtij ligji të hyjnë në fuqi.

3. Detyrimi për afatin e mbartjes së numrit, sipas pikës 9 të nenit 87 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, shtuar me pikën 4 të nenit 32 të këtij ligji, zbatohet 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Hyrja në fuqi e detyrimit për ruajtjen e të dhënave, të parashikuara në nenin 101 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar me nenin 36 të këtij ligji, për shërbimin e internetit, zbatohet 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

5. Neni 52 i këtij ligji zbatohet 6 muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

6. Emërimi i Kryetarit të Këshillit Drejtues dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues për mandatin e parë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të bëhen nga Kuvendi, për kryetarin për një periudhë 5-vjeçare, për dy prej anëtarëve për një periudhë 4-vjeçare dhe për dy anëtarët e tjerë për një periudhë 3-vjeçare.

7. Vendimet e Këshillit të Ministrave, të dala në zbatim të neneve 69, 117 dhe 119 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, mbeten në fuqi deri në daljen e vendimeve përkatëse, në përputhje me këtë ligj.

Neni 62

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të neneve 12 pika 3 dhe 27 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për miratimin e aktit nënligjor, sipas nenit 9 të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Ngarkohet AKEP-i për ndryshimin dhe miratimin e rregulloreve të miratuara në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 63

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.10.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7814, datë 8.11.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 13.11.2012
Doli nga shtypi më 14.11.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 52 lekë